

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6101
E hënë, 31 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Senatorit Bob Dole i ngrehet bust në Prishtinë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË TË ZHDUKURVE, KOSOVA PËRKUJTON
1 643 PERSONAT PËR FATIN E TË CILËVE ENDE NUK DIHET

NDËRKOMBËTARËT T'I BËJNË PRESION SERBISË PËR TË PAGJETURIT




Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë fajësuar bashkësinë ndërkombëtare dhe Serbinë për moszbardhjen e fatit të 1 643 personave

të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, ata kanë kërkuar që bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë tryzni Serbisë për

zbardhjen e fatit të këtyre personave. Sipas tyre, është e pamundshme një marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa zbardhjen e fatit të të zhdukurve

Kërkohet pezullimi i udhëzimit administrativ për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2020 për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve, i nxjerrë nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar (KKRF), është kërkuar që të pezullohet për shkak të rrethanave pandemie dhe koston shtesë për të bërë biznes në Kosovë. Sipas përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë, Arian Zeka, Berat Rukliqi, si dhe Skender Krasniqi, ky udhëzim, përpos që është barrë shtesë për bizneset, sidomos tani në kohë pandemie, është



nxjerrë pa konsultim paraprak të partneritetit publiko-privat

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Tetë të vdekur, 119 raste të reja dhe 118 të shëruar nga Covidi në Kosovë



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

ZOTËRI MARTY, KENI
URREJTJE TË PAKUFISHME
PËR LUFTËN ÇLIRIMTARE
DHE UÇK-në (40) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

KURTI: QEVERITARËT
E KANË MENDJEN TE POSTET
DHE TENDERËT F. 7

TAKIMI I UASHINGTONIT, HOTI:
KOALICIONI ËSHTË UNIK F. 6



EKONOMI

OSMANI: NDËRMARRJET
PUBLIKE NË GJENDJE TË KEQE,
GJASHTË PREJ TYRE KANË
RRETH 30 MILIONË EURO
BORXHE F. 8

ODA E HOTELERISË KËRKON NGA
QEVERIA TË HIQEN KUFIZIMET
PËR BIZNESET F. 8

VIT REKORD I RENDIMENTEVE
TË GRURIT NË KOSOVË F. 8

SPORT

BEKAJ, PAS TRANSFERIMIT TE
TIRANA: NUK I NDËRROVA
NGJYRAT PËR TË CILAT NDIHEM
KRENAR F. 18

Votuan malazetët, rezultati pritet të jetë i ngushtë

PODGORICË, 30 GUSHT - Malazetët kanë votuar të dielën për zgjedhjet parlamentare në të cilat as partia prorepublicane në pushtet dhe as aleanca rivale proserbe dhe proruse nuk pritet ta fitojnë shumicën e deputetëve. Në këto votime do të vendoset

edhe e ardhmja politike e presidentit Milo Gjukanoviq. Ai ka udhëhequr Partinë Demokratike të Socialistëve (DPS), e cila ka qeverisur Malin e Zi që nga fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë federale në vitin 1990, si dhe përgjatë shpërbërjes së

unionit me Serbinë në vitin 2006. Gjukanoviqi, një prorepublican i vendosur, ka drejtuar përpjekjet ende në vazhdim të Malit të Zi për t'u kualifikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si dhe ka luajtur rol të rëndësishëm për anëtarësimin në NATO në

vitin 2017. DPS-ja përballet në këto zgjedhje me aleancën "Për të Ardhmen e Malit të Zi", e përbërë kryesisht nga parti nacionaliste serbe që dëshirojnë marrëdhënie më të afërta me Serbinë dhe Rusinë. Në zgjedhjet e 30 gushtit, përveç Listës Shqiptare, e cila për-



bëhet nga pesë subjekte politike, ka marrë pjesë edhe Koalicioni Shqiptar "Njerëzia".

Dallimet e politikës së jashtme të dy kandidatët presidencialë

WASHINGTON, 30 GUSHT - Kuvendi Kombëtar Republikan e ka portretizuar presidentin Donald Trump si një komandant i fortë që mposht armiqtë dhe që kërkon më shumë aleatë. Kundërshtari i tij, ish-nënpresidenti Joe Biden, ka thënë se do të qëndrojë përkrah aleatëve amerikanë dhe jo diktatorëve. "Zëri i Amerikës" ka sjellë këtë analizë mbi vizionin e paraqitur nga të dy kandidatët për marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara me botën. Në fjalimin e tij të pranimit në Kuvendin Kombëtar Republikan, presidenti Donald Trump ka argumentuar se kundërshtari i tij, i emëruari demokrat për president, Joe Biden, është një udhëheqës i dobët që do ta shkatërojë vendin. "Joe Bideni e kaloi karrierën duke larguar në vende të tjera ëndrrat e

punëtorëve amerikanë, duke dërguar në vende të tjera vendet e tyre të punës, duke hapur kufijtë dhe duke dërguar djemtë dhe vajzat e tyre për të luftuar në luftëra të pafundme të huaja", ka thënë Trumpi.

Gjatë Kuvendit Kombëtar Demokrat, Bideni, nënpresident gjatë administratës Obama, e ka portretizuar Trumpin si një udhëheqës i rrezikshëm që e ka shkatërruar pozicionin e Amerikës në botë. "Unë do të jem një president që do të qëndroj me aleatët dhe miqtë tanë dhe do t'ua bëj të qartë kundërshtarëve tanë, se ditët e afërimit me diktatorët kanë mbaruar. Nën presidentin Biden, Amerika nuk do të bëjë një sy të verbër ndaj pagesave ruse për të vlarë ushtarë amerikanë", ka thënë Bideni.

Platforma e politikës së jashtme e



demokratëve kundërshtoi "luftërat pa mbarim" dhe propozoi më pak shpenzime për mbrojtjen kombëtare si dhe kritikoi praktikën tregtare të Kinës. Republikanët nuk e kanë formuluar një platformë këtë vit, por kanë thënë se mbështesin njëzëri vizionin e presidentit Trump për marrëdhëniet me jashtë. Partia Republikane vazhdon ta mbështesë politikën

e jashtme të presidentit Trump, të cilën ai e përmbledh me parimin "Amerika e Parë", një parullë që u bë popullore gjatë fushatës së tij në vitin 2016. Synime të tjera të politikës së jashtme: "sjellja e trupave amerikane në atdhe" dhe "dhënia fund e varësisë të Kinës". Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, e ka përgëzuar politikën "Amerika e para" të presidentit

Trump. Ndërsa demokratët e kanë paraqitur republikanin Colin Powell, ish-sekretarin e Shtetit nën administratën Bush në kuvend, i cili ka thënë se Bideni do të kujdeset për trupat amerikane. Fjalimi i presidentit Trump është përqendruar kryesisht te Kina në kontekstin e pandemisë, marrëdhënieve tregtare dhe vendet e punës, duke pretenduar se Pekini do t'i zotëronte Shtetet e Bashkuara nëse Joe Bideni do të zgjidhej president.

Të dy kandidatët kanë paraqitur qëndrime të ndryshme, ku politika e jashtme nuk është një faktor vendimtar në zgjedhje, kanë thënë analistët amerikanë. Megjithatë, kandidatët pritet ta diskutojnë atë gjatë debateve në shtator, përfshirë çështjen e ndërhyrjes së huaj në zgjedhjet e nëntorit.

Bjellorusia ua ndalon raportimin gazetarëve të huaj

MINSK, 30 GUSHT - Një sërë gazetarësh të huaj nuk do të lejohen më të raportojnë në Bjellorusi pasi akreditimi i tyre është tërhequr në mënyrë të papritur, e disa mund të dëbohen nga vendi. Masa e ashpër vjen përpara protestave të reja masive që priten kundër presidentit Aleksandër Lukashenko. Akreditimi u është hequr gazetarëve që punojnë për agjencitë e lajmeve "Agence France Presse", "Associated Press", transmetuesin britanik "BBC", atë publik gjerman



"ARD" dhe "Radion Evropa e Lirë". "ARD"-ja madje ka njoftuar se një ekip

kameramanësh të tij janë arrestuar gjatë natës, edhe pse kishin akreditimin e duhur. Ata

janë lënë të lirë, por akreditimi u është hequr, ndërsa dy anëtarëve rusë u është kërkuar të largohen menjëherë nga vendi. Producenti i tyre bjellorus është kërcënuar me veprime ligjore. Nuk është ende e qartë për momentin se sa gazetarë preken saktësisht nga kjo masë, ndonëse Shoqata e Reporterëve Bjellorusë flet për një valë masive tërheqjesh të akreditimit për gazetarët që punojnë për TV, radio, gazeta dhe agjenci lajmesh. Ditët e fundit, mbi një duzinë

reporterësh që mbulonin protestat në Minsk janë ndaluar nga policia për kontroll dokumentesh, e në disa raste, efektivët u kanë fshirë atyre video dhe foto. Lëvizja kundër gazetarëve vjen përpara protestës në shkallë të gjerë që pritet të mbahet në kryeqytet dhe goditja e medias shihet si përpjekje për ta parandaluar raportimin mbi tubimin mbarëkombëtar, pjesë e protestave masive që përfshinë vendin pas zgjedhjeve të diskutueshme presidenciale.

Turqia kërcënon me luftë

ANKARA, 30 GUSHT - Një zgjerim i mundshëm i ujërave territoriale greke përgjatë kufirit detar me Turqinë do të ishte një arsye për luftë, ka thënë ministri i Jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu. "Ne nuk do të lejojmë që Greqia

t'i zgjerojë ujërat e saj territoriale në Detin Egje në 12 milje", është cituar Çavusoglu nga "Daily Sabah". Paralajmërimi ka ardhur pasi kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis ka njoftuar javën e kaluar se ujërat

territoriale greke në Detin Jon, drejt Italisë, do të zgjeroheshin nga gjashtë në 12 milje. Turqia dhe Greqia kanë gjashtë milje det territorial në Detin Egje, ku një numër i madh i ishujve grekë ndodhen jo shumë

larg bregdetit turk. Greqia dhe Turqia, të dyja anëtare të NATO-s, kanë debatuar ditët e fundit rreth planeve turke për kërkime në Mesdheun lindor, i cili besohet të jetë i pasur me naftë dhe gaz.



Kosova shënon 30-vjetorin e vizitës së senatorit amerikan Bob Dole

Senatorit Bob Dole i punohet një bust në Prishtinë

Kosova ka nderuar të dielën mikun e madh amerikan, senatorin Bob Dole, duke ia zbuluar bustin në rrugën që mban emrin e tij në Prishtinë. Kjo ngjarje ka ndodhur në 30-vjetorin e vizitës së delegacionit të Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të udhëhequr nga Dole në Kosovë në vitin 1990. Përfaqësuesit institucionalë dhe politikë të Kosovës e kanë vlerësuar lart rëndësinë e kësaj vizite për Kosovën, ndërsa senatori Dole ka shprehur mirënjohje për inaugurimin e bustit të tij në Prishtinë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Busti i senatorit amerikan Bob Dole është zbuluar të dielën në Prishtinë, me rastin e 30-vjetorit të vizitës së delegacionit të Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i udhëhequr nga Dole në Kosovë në vitin 1990. Përfaqësuesit institucionalë

dhe politikë të Kosovës e kanë vlerësuar lart rëndësinë e kësaj vizite për Kosovën, ndërsa senatori Dole përmes një video-mesazhi ka shprehur mirënjohje për inaugurimin e bustit në Prishtinë. "Më vjen keq që nuk mund të jem me ju në inaugurimin e bustit. Ma kujton kohën para 30 vjetëve. Tridhjetë vjet kemi punuar për të krijuar një shtet të fortë dhe shpresoj se do të vazhdoni të

punoni për t'u bërë edhe më të fortë", ka deklaruar Dole.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka marrë pjesë në ceremoninë e zbulimit të bustit, ka deklaruar se është nder i veçantë zbulimi i bustit të një personi siç është senatori Bob Dole. "Ai është një person që, po ta lexosh CV-në e tij, punën e tij, padyshim që impresionohesh. Jam i bindur që secili nga ne e merr si simbol dhe shembull të përkushtimit se si duhet të jetë një politikan, një atdhetar për vendin e vet në luftë dhe në paqe. Unë jam i bindur që ky bust këtu të jetë vend ku edhe gjeneratat e ardhshme do të mësojnë për historinë e tij, historinë e ndërtimit të miqësive në mes të dy popujve tanë dhe do të inspirohen për kontributin dhe dedikimin që duhet të kemi secili nga ne për vendin tonë", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook".

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kujtuar vizitën historike të delegacionit të Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, duke thënë se tri dekada më parë filloi një epokë e re e marrëdhënieve Kosovë - ShBA.

Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se ndihet i lumtur që angazhimi shumëvjeçar i senatorit Dole për Kosovën po përjetësohet në qendër të

Prishtinës përmes inaugurimit të bustit. "Tri dekada më parë filloi një epokë e re në marrëdhëniet e popullit të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Delegacioni i Senatit të ShBA-së, i udhëhequr nga miku i madh i Kosovës, Bob Dole, solli mesazhin e mbështetjes amerikane për popullin tonë. Jam shumë i lumtur që angazhimi shumëvjeçar i senatorit Dole për Kosovën sot po përjetësohet në qendër të Prishtinës përmes inaugurimit të bustit të tij. Bob Dole është hero i gjallë i popullit të ShBA-së dhe i popullit të Kosovës", ka shkruar Thaçi.

Në inaugurimin e bustit ka marrë pjesë edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke e vlerësuar lart vizitën e senatorit amerikan Bob Dole, 30 vjet më parë në Kosovë. "Lapidari i senatorit Bob Dole në kryeqytet, përpos që nderon mikun e madh të popullit të Kosovës, ai simbolizon edhe ngjarjen historike të 29 gushtit 1990, që shënoi kthesë të madhe e u dha orientim zhvillimeve që do të pasonin. Të kryesuar nga Bob Dole, senatorët amerikanë vërtetuan prej së afërmi ndjenjat e një populli të robëruar, liritë e të cilit i kufizoheshin çdo ditë, mbijetesa e të cilit vihej në rrezik. Aleanca e shqiptarëve me Shtetet e Bashkuara do të niste

një kapitull të ri, i cili, i kurorëzuar me shumë suksese në dobi të demokracisë dhe të drejtës së shqiptarëve, të jenë zotë në shtëpinë e tyre", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Ndërtimi i bustit i senatorit Bob Dole u bë nga artisti i njohur Luan Mulliqi. Projekti u financua nga Oda Amerikane në Prishtinë. Busti ndodhet në rrugën "Bob Dole" në lagjen Dardania të kryeqytetit, kurse emrat e delegacionit të senatorit amerikan, kryesuar nga senatori Bob Dole, janë vendosur në pllakën përkujtimore në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Zbulimi i pllakës është bërë sot nga ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla.

Më 29 gusht 1990 delegacioni i senatorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i udhëhequr nga senatori Bob Dole, vizitoi Kosovën për herë të parë. Kjo vizitë u organizua në kohën e heqjes së njëanshme të statusit të njësive federale të Kosovës brenda Jugosllavisë dhe imponimit të politikave diskriminuese ndaj popullatës etnike shqiptare në Kosovë nga Serbia. Qëllimi i kësaj vizite ishte mbledhja e informatave të drejtpërdrejta në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut që janë kryer në mënyrë sistematike kundër popullit të Kosovës nga regjimi serb.



Ambasada e ShBA-së: Senatori Dole mbajti premtimin e dhënë para 30 vjetësh për lirinë e Kosovës

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka reaguar pas ngritjes së bustit të senatorit amerikan Bob Dole sot në Prishtinë. Përmes një postimi në "Facebook", kjo ambasadë ka vlerësuar se senatori Dole ka mbajtur premtimin e dhënë para 30 vjetësh për lirinë e Kosovës. "30 vjet më parë senatori Dole erdhi në Kosovë dhe bëri një premtim: Liria po

vjen. Demokracia po vjen. Ky premtim u mbajt dhe Shtetet e Bashkuara kanë qëndruar pranë kësaj qysh prej atëherë", është thënë në postimin e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë.

30 vjet më parë, më 29 gusht 1990, senatori Robert Dole, me gjashtë kolegë të tij, vizitoi Prishtinën, duke luajtur një rol të pakrahasueshëm për ndërkombëtarizimin e Kosovës.

Pacollit i ngrëhet bust në Sarandë


SARANDË, 30 GUSHT (ER) - Ish-presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli, i është ngrëhur një bust në qytetin e Sarandës në Shqipëri. Ai është shprehur i lumtur për

këtë vepër, duke thënë se i është bërë nder i madh. "Një dhuratë që nuk e prisja. Sot, me rastin e ditëlindjes sime, kuptova se në qytetin e bukur të Sarandës është

realizuar një bust për mua. Jam i lumtur dhe shumë mirënjohës për këtë portret. Gjatë jetës sime, kam punuar shumë për ta bërë popullin tim krenar dhe për

t'i treguar botës se edhe ne dimë dhe mundemi! Ky është një nder i madh për mua sot! Falënderoj nga zemra autorin Alket Halili!", ka shkruar Pacolli.





NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË TË ZHDUKURVE, KOSOVA PËRKUJTON
1 643 PERSONAT PËR FATIN E TË CILËVE ENDE NUK DIHET

NDËRKOMBËTARËT T'I BËJNË PRESION SERBISË PËR TË PAGJETURIT

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë fajësuar bashkësinë ndërkombëtare dhe Serbinë për moszbardhjen e të fatit të 1 643 personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, ata kanë kërkuar që bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për zbardhjen e fatit të këtyre personave. Sipas tyre, është e pamundshme një marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa zbardhjen e fatit të të zhdukurve

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 GUSHT - Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë kërkuar zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, ata kanë fajësuar bashkësinë ndërkombëtare dhe Serbinë për moszbardhjen e të fatit të 1 643 personave të zhdukur. Sipas tyre, bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë trysni mbi Serbinë për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se çështja e

të pagjeturve është turpi i bashkësisë ndërkombëtare. "Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve kujtojmë 1 647 qytetarët tanë të pagjetur. Çështja e të pagjeturve është turpi i bashkësisë ndërkombëtare dhe është për keqardhje që Serbia po e politizon edhe zbardhjen e fatit të tyre. Bashkësia ndërkombëtare duhet t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet që kanë dispozicion për t'i bërë presion Serbisë dhe për ta zbardhur fatin e të pagjeturve dhe çdo krim të kryer në Kosovë. Nuk do të ndalemi asnjëherë së kërkuari që të zbardhet fati i tyre. Nuk do të ndalemi

asnjëherë së kërkuari drejtësi për çdo viktimë, për çdo të zhdukur, për çdo familje", ka shkruar presidenti në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se është e pamundshme një marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa zbardhjen e fatit të të zhdukurve. "Sot Kosova dhe e gjithë bota shënon Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve. Ditë kjo në funksion të ngritjes së zërit për ta zbardhur fatin e të gjithë atyre që nuk janë në mesin tonë, fati i të cilëve përbën shqetësim jo vetëm për familjarët, por për shoqërinë në përgjithësi. Dy

dekada pas luftës, të zhdukurit me dhunë mbesin plaga më e madhe dhe më e dhimbshme e shtetit tonë. Janë 1 643 fate jetësore për të cilat institucionet nuk arritën të bëjnë asgjë përgjatë këtyre 21 vjetëve. Sot peshja e fatit të tyre rëndon mbi secilin politikan të Kosovës. Mbi ne bie përgjegjësia e zbardhjes së fatit të secilit, ndërkaq peshja e fajit bie mbi shtetin e Serbisë", ka vlerësuar ajo në një deklaratë për media.

Ajo ka deklaruar se paqe në mes të dy vendeve nuk do të ketë përderisa secila nënë e baba nuk e gjen fëmijën e vet. "Sot ne nuk e kemi një përgjigje përfundimtare për familjarët e tyre, siç nuk e kemi as argumentin kryesor: si mund të ketë një marrëveshje përfundimtare me Serbinë teksa nuk e dimë ku i kemi njerëzit tanë, të cilët ajo i mori dhunshëm! Rrjedhimisht duket e pamundshme dhe anakronike një marrëveshje përfundimtare pa zbardhje të fatit të të

zhdukurve dhe pa adresim të fajit ndaj shtetit serb. Paqe nuk do të ketë përderisa secila nënë e baba nuk e gjen fëmijën e vet. Paqja ndërshtetërore e ka parakusht paqen shpirtërore të 1 643 familjeve në Kosovë", ka thënë Osmani. Në anën tjetër, kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka bërë homazhe duke vendosur kurora me lule tek Obelisku i personave të pagjetur.

Ai ka thënë se kjo çështje duhet të zgjidhjet në çfarëdo marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Unë së bashku me kabinetin qeveritar dolëm t'i bëjmë nderimet e zakonshme. Kjo për ne është plagë e hapur akoma dhe është tema më e ndjeshme edhe pas 20 vjetësh. Nuk është e tepërt ta them se kjo është tema kryesore në çfarëdo marrëveshje që arrihet për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Nuk mund të jem i qetë derisa familjet e të pagjeturve të dinë ku i kanë të



dashurit e tyre”, ka deklaruar Hoti.

Zbardhjen e fatit të të pagjeturve e kanë kërkuar edhe liderët e tjerë politikë.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare që të bëjë trysni mbi Serbinë për këto krime. “21 vjet pas përfundimit të luftës, në listën e personave të pagjetur të Kosovës ende figurojnë edhe 1 647 emra. Shteti serb ka përgjegjësinë dhe ende mban në ankth shumë familje nga Kosova, duke mbajtur të fshehura shumë informacione që i ka për njerëzit e rrëmbyer e pastaj të vrarë e masakruar”, ka shkruar Veseli në profilin e vet në “Facebook”.

Sipas tij, formimi i tribunalit ndërkombëtar për gjenocidin dhe krimet që Serbia ka kryer në Kosovë është i pashmangshëm. “Dhimbja dhe vuajtjet e familjeve dhe të afërmeve të viktimave janë tejet të mëdha. Bashkësia ndërkombëtare duhet të ushtrojë trysni, që krimet e kryera nga Serbia të mos vazhdojnë të mbulojnë, duke ikur nga përgjegjësitë minimale humane për ta pranuar fajin dhe respektuar viktimat. Formimi i Tribunalit Ndërkombëtar për gjenocidin dhe krimet që Serbia ka kryer në Kosovë është i

pashmangshëm”, ka vlerësuar Veseli.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se të zhdukurit mbesin plagë e hapur për kombin. “Motrat, vëllezërit e fëmijët tanë të pagjetur nuk janë vetëm numra. Ata mbesin plagë e hapur për kombin, dhembje që vazhdon edhe njëzet e një vjet pas çlirimit. Ata nuk bënë ndonjë faj. Të kërkosh të jetosh i lirë në dheun e të parëve nuk përbën krim, por është një drejtë e garantuar nga Zoti për secilin. Në ditën kur bota kujton personat e zhdukur, zemra jonë rrah me familjarët që presin të dashurit e tyre. Me ta do të jemi derisa të zbardhet e vërteta dhe vendoset drejtësia”, ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në “Facebook”.

Në Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë thirrje që të ndriçohet një herë e përgjithmonë fati i mbi 1 600 personave të zhdukur tash e mbi dy dekada. Kreu i Nismës ka thënë se nuk do të ndalet asnjëherë së kërkuari drejtësi dhe zbardhjen e fatit të të gjithë të zhdukurve. “Kjo plagë e cila është ndër më të rëndat që ka shkaktuar lufta, vazhdon të rëndojë mbi familjet e personave të zhdukur, shoqërinë dhe shtetin tonë në përgjithësi”, ka thënë Limaj.

EULEX-i: Jepni mostrat e gjakut, mund të identifikohen deri në 20 persona

Zëvendësdrojtresha e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe ekspertja e EULEX-it, Tarja Formisto, në Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjes së Dhunshme, ka deklaruar se njëri prej problemeve të ballafaquara gjatë procesit të identifikimit të mbetjeve mortore është fakti se jo të gjithë të afërmit e personave të pagjetur i kanë dhënë mostrat e tyre të gjakut për analizën e ADN-së. “Ka familje të cilat refuzojnë t’i japin mostrat e gjakut për arsye të ndryshme. Disa besojnë se të afërmit e tyre janë ende gjallë, të tjerët nuk duan t’i japin mostrat e gjakut përpara se kryerësit e veprave të sillen përpara drejtësisë”, ka thënë Formisto.

Ajo ka thënë se sikur familjarët e të gjithë personave të pagjetur t’i jepnin mostrat e gjakut, deri në 20 persona të pagjetur do të mund të identifikoheshin me anë të ADN-së. “Unë dëshiroj t’u bëj apel të afërmeve të të gjithë personave të pagjetur që t’i japin mostrat e gjakut ashtu që ne të mund ta përfundojmë procesin e identifikimit për disa prej tyre”, ka deklaruar ajo.

Ajo ka deklaruar se ekziston

mungesë e informacioneve të reja dhe të besueshme për lokacionin e saktë të varrezave, duke shtuar se disa prej mbetjeve mortore janë në varreza masive, disa prej tyre në varreza klandestine më të vogla, si dhe nëpër varreza në zona të ndryshme, gjë që e bën më të vështirë procesin e lokalizimit të mbetjeve mortore. “Ekziston, gjithashtu, edhe çështja e një numri të caktuar të keqidentifikimeve. Menjëherë pas konfliktit kufomat janë identifikuar në mënyrë të përgjithësuar, për shembull nëpërmjet fotografive, rrobave apo gjësendeve personale, që ka rezultuar në gabime të cilat sot është vështirë të gjurmohen dhe të korrigjohen”, ka shpjeguar ajo për “Rel”.

Ekspertja e EULEX-it vazhdojnë të punojnë në Kosovë së bashku me kolegët në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Prej fillimit të mandatit të EULEX-it e deri më sot ky mision thuhet se ka kryer 656 operacione në terren për t’i lokalizuar personat e pagjetur, përfshirë 166 zhvarrime. Po sipas EULEX-it, janë identifikuar mbetje mortore të 456 individëve, përfshirë 316 persona të pagjetur.

Konjufca: Hapja e 58 shtëpive në veri në ditën e të pagjeturve, jo e rastësishme



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Zyrta i lartë i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka reaguar në lidhje me hapjen e 58 shtëpive të reja në veriun e Kosovës. Sipas tij, hapja e tyre në Ditën e të Pagjeturve nuk është e rastësishme nga ana e shtetit të Serbisë. “Përcaktimin e vërtetë të shtetit serb ndaj shqiptarëve dhe Kosovës e tregon më së miri ngjarja e sotme

në pjesën e veriut të shtetit tonë. Pikërisht sot, pra në Ditën e të Pagjeturve, Serbia i hapi 58 shtëpi të reja në pjesën e veriut të Kosovës. Nuk është e rastësishme as data që e ka zgjedhur Serbia. Përmes kësaj tregon që nuk ka asnjë keqardhje a pendesë për gjenocidin e shkaktuar në Kosovë. Përkundrazi, jo vetëm që e mban të burgosur të vërtetën për të rrëmbyerit, por e

vazhdon para hundës së qeverisë tonë kolonizimin e Kosovës”, ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka thënë se një veprim i tillë është kolonizim tipik. “58 shtëpi të koncentruara, në një lagje të vetme, në pjesën më strategjike të pjesës së veriut. Shtëpi të ndërtuara nga qeveria e Vuçiqit aty ku më parë kurrë nuk kishte asnjë shtëpi. Në anën

tjetër delegacioni i Kosovës për dialog me Serbinë në Bruksel pranon tema të tilla siç ishte kthimi i serbëve që e kanë lëshuar Kosovën që prej vitit 1976. Në momentin që pranohet për dialog një temë e tillë, automatikisht legjitimohet teza e Akademisë Serbe se shqiptarët paskan ushtruar presion dhe aparteid ndaj serbëve të Kosovës. Përmes këtyre kon-

strukteve shoviniste Serbia synon ta mbulojë gjenocidin e ushtruar ndaj shqiptarëve. Asnjë reagim nga Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Kur ta merr vesh kryeministri Hoti këtë veprim nga mediat, me siguri del dhe e dënon ‘ashpër’. E kjo është dukshëm më pak se që bën një OJQ aktive për këtë çështje”, ka shkruar Konjufca.

Bahtiri për takimin e Uashingtonit: Askush nuk guxon të diskutojë për territorin e Kosovës

MITROVICË, 30 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të jetë e kujdesshme në dialogun në Uashington, duke mos bërë kompromise në dëm të shtetit. Ai ka thënë se askush nuk guxon të diskutojë për territor të Kosovës, për Asociacionin e Komunave Serbe dhe për amnistimin e krimeve të luftës. “Në takimin që do të mbahet në Uashington Qeveria e Kosovës duhet të jetë shumë e kujdesshme dhe mos të bëjë kompromise në dëm të Republikës së Kosovës në emër të ashtuquajturës ‘marrëveshje historike’. Askush nga pala e Kosovës nuk guxon

që të diskutojë për shkëmbime territoriale, asociacion të komunave serbe dhe amnisti për krimet e kryera gjatë luftës. Çdokush që ka guxim t'i diskutojë këto tri çështje do të përballet fuqishëm me kundërshtim nga qytetarët e qytetit të Isa Boletinit, e pastaj edhe me gjithë Kosovën. Në rrethana normale kjo qeveri, duke qenë se është jolegjitime për shkak të mandatit të vjedhur, nuk është dashur të marrë pjesë në këtë takim, pasi që është e shantazhuar nga Lista Serbe dhe s'ka kredibilitet, e as nuk përfaqëson shumicën e qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar Bahtiri në llogarinë e vet në “Facebook”.



Takimi i Uashingtonit, Hoti: Koalicioni është unik



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se vetëm njohja reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë i normalizon marrëdhëniet në mes të dy vendeve. “Në çdo takim që kemi, tema e vetme për çfarëdo që bisedojmë, çdo gjë është në funksion të njohjes reciproke, ndryshe nuk normalizohen raportet”, ka thënë Hoti. Ai ka treguar se si koalicion është unik sa i përket dialogut me Serbinë. “Si koalicion jemi plotësisht unik. Ju e dini që unë kam kërkuar edhe nga opozita që të jetë pjesë e këtyre zhvillimeve, por unë jam duke u angazhuar, duke punuar, në bazë të kompetencave kushtetuese, për

ta përfaqësuar shtetin e Kosovës në këto bisedime”, është shprehur Hoti.

Dy partitë politike opozitare në Kosovë nuk kanë ndryshuar qëndrim për të qenë pjesë aktive e dialogut politik me Serbinë. Ato e kanë kritikuar në vazhdimësi qeverinë Hoti për mungesë të strategjisë në këtë proces. Procesi i dialogut ka vazhduar në nivel teknik në Bruksel ditë më parë, ku është diskutuar kryesisht për çështje ekonomike. Përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë pritet të takohen më 4 shtator në Uashington. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka paralajmëruar se pret negociata të vështira dhe befasi nga ky takim.

Gjilani nis shpërndarjen e librave falas për mbi 12 mijë nxënës

“Kemi pranuar librat nga Ministria e Arsimit dhe jemi duke i shpërndarë në bazë të numrit të nxënësve dhe shkollave të Komunës së Gjilanit”, tha Nazim Gagica, drejtor i DKA-së

GJILAN, 30 GUSHT (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Gjilan ka filluar të dielën shpërndarjen e librave falas për 12 282 nxënës, përfshirë edhe mjetet didaktike për grupmoshën 5-6 vjeç, si institucionet parashkollore dhe çerdhet. Nazim Gagica, drejtor i DKA-së, ka falënderuar Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, duke informuar se ky proces i shpërndarjes do të përfundojë javën e ardhshme për të gjitha institucionet edukative dhe arsimore të Komunës së Gjilanit.

“Kemi pranuar librat nga Ministria e Arsimit dhe jemi duke i shpërndarë në bazë të numrit të nxënësve dhe shkollave të Komunës së Gjilanit. Janë të angazhuar të gjithë menaxherët dhe stafi i shkollave, duke përfshirë këtu edhe stafin e DKA-së. Dita e parë e shkollës do të jetë e kompletuar edhe nga aspekti i literaturës, por edhe përgatitjeve që i kemi bërë në vazhdimësi për fillimin e mësimin nëpër shkollat e Gjilanit. Urojmë që gjithçka të ecë në bazë të planifikimit që kemi bërë”, ka thënë Gagica.



Oda e Hotelierisë kërkon nga qeveria të hiqen kufizimet për bizneset



PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Oda e Hotelierisë dhe Turizmit e Kosovës (OHTK) ka kërkuar nga qeveria që t'i heqë kufizimet ndaj bizneseve. Kjo odë ka vlerësuar se është zvogëluar numri i të infektuarve dhe se këto biz-

nese nuk kanë qenë shkak të Covidit. OHTK-ja ka kërkuar që të hapen edhe ambientet e mbyllura, si dhe sallat e dasmave, duke iu përmbajtur rregullave të vendosura me ligj. "Numri i madh i gjobave të këto biz-

nese vë në dyshim punën e inspektoratit, prandaj OHTK-ja kërkon që të sillen konform ligjit aktual që është në fuqi. OHTK-ja përkrah shembullin e Komunës së Prishtinës dhe të Obiliqit që t'i lirojë nga tatimet deri në

fund të vitit këto biznese", është thënë në komunikatën e OHTK-së, duke bërë me dije se nëse nuk merren masa për lirimin nga kufizimet e parapara, do të shqyrtohet mundësia për të marrë masa të tjera.

Osmani: Ndërmarrjet publike në gjendje të keqe, gjashtë prej tyre kanë rreth 30 milionë euro borxhe

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka gjetur shkelje të ndryshme në institucionet qendrore, lokale dhe në ndërmarrjet publike, në auditimin e tyre të bërë për vitin 2019. Shqetësuese për auditorin është gjendja e ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime për qytetarët si në fushën e telekomunikimit dhe shërbimeve të tjera publike si ujë, menaxhimit të mbeturinave dhe ndërmarrjeve të tjera në fushën e ambientit.

Besnik Osmani, auditor i përgjithshëm i ZKA-së, ka thënë se nga 14 ndërmarrje publike sa janë audituar, për 13 prej tyre kanë qenë të detyruar të japin opinion negativ. Ai ka thënë se shumica e ndërmarrjeve operojnë me humbje, ndërsa një pjesë e vogël e tyre me fitime

simbolike. "Gjendja më e keqe qëndron të ndërmarrjet publike, ku nga 14 ndërmarrje publike që kemi audituar për 13 prej tyre jemi detyruar të japim opinion negativ. Gjashtë ndërmarrje publike kanë rreth 30 milionë euro borxhe të pashlyera dhe operojnë me humbje, ndërsa 8 prej tyre nëse i mbledhim kanë vetëm një fitim simbolik", ka thënë Osmani. Ai ka thënë se ndër të gjeturat serioze është edhe planifikimi jo i duhur i buxhetit nga qeveria. "Qeveria ka planifikuar që do të ketë një buxhet rreth 37 milionë deficit buxhetor, pra që do të ketë më shumë shpenzime sesa që ka kapacitete për t'i inkasuar të hyrat. Derisa në fund të vitit kemi pasur një rezultat tjetër, ku buxheti është shpenzuar 96.8 për qind dhe janë 70 milionë euro



suficit që kanë mbetur në bilancin bankar me rastin e mbylljes së llogarive më 31 dhjetor të vitit kalendarik", ka thënë Osmani. Sipas tij, shteti vazhdon të ketë ngecje sa i përket edhe arkëtimit dhe detyrimeve, ku vlera e detyrimeve që ka shteti

ndaj qytetarëve dhe bizneseve është rreth 6 milionë euro. Osmani ka thënë se institucionet ngecin edhe sa i përket zbatimit të rekomandimeve që jep Zyra e Kombëtare e Auditimit. Sipas tij, në këtë aspekt më keq qëndron niveli lokal, raporton "EO". "Kemi

dhënë 951 rekomandime një vit më herët, vetëm 40 për qind e tyre janë zbatuar plotësisht, 36 për qind nuk janë prekur fare dhe pjesa tjetër janë në proces", është shprehur ai. Rishikimi i buxhetit për vitin 2020 ka prekur ZKA-në. Osmani ka thënë se me rishikim të buxhetit ka prekur një projekt të rëndësishëm të këtij institucioni. "Miratimi i buxhetit për vitin 2020 nuk ka përfshirë disa elemente të rëndësishme për zbatimin e planit tonë strategjik. Ka pasur një shkurtim të buxhetit shumë të rëndësishëm, ka të bëjë me një softuer i cili rrit sigurinë në auditim e zvogëlon kohën e nevojshme në auditim, rrit transparencën, por edhe një nga masat më rëndësishme për eliminimin e gabimeve të punës sonë", ka thënë Osmani.

Vit rekord i rendimenteve të grurit në Kosovë

PRISHTINË, 30 GUSHT - Fermeri Shaqir Sallahu nga Komuna e Ferizajt ka pasur të kultivuar mbi 100 hektarë tokë më kulturën e grurit. Ai ka treguar se gjatë këtij viti cilësia dhe sasia e grurit ka qenë në nivel të kënaqshëm. Për një hektar sipërfaqe, Sallahu ka thënë se ka grumbulluar mbi 5 500 kilogramë grurë. "Ne kemi përfunduar korrje-shirjet dhe jemi të kënaqur gjatë këtij viti. Unë jetoj nga kjo punë dhe nuk kam të ardhura të tjera", ka thënë Sallahu. Ndërsa zyrtarë të Qeverisë së Kosovës kanë pohuar se cilësia dhe sasia e rendimenteve të grurit gjatë këtij sezoni pritet të jetë më e larta krahasuar në dhjetë vjetët e fundit. Fushata e korrje-shirjeve të kësaj kulture bujqësore, sipas tyre, tashmë ka përfunduar në mbi 99 për qind të sipërfaqeve të kultivuara në gjithë territorin e



Kosovës dhe zë përqindjen më të madhe të tokës me rreth 65 mijë hektarë.

Isuf Cikaqi, drejtor në Departamentin për Politika Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në bazë të të dhënave preliminare, sasia e

prodhimit të grurit paraqitet rekord gjatë kësaj sezone, pasi deri në 4 700 kilogramë grurë janë siguruar për hektarë. "Në raport më vitet e tjera, do të jetë vit rekord i rendimentit, do të jetë nga 4 600 deri në 4 700 kilogramë për hektarë. Po them vit rekord për arsye se në vitin 2011 ka qenë viti rekord i grurit kur janë siguruar 4

600 kilogramë për hektarë", ka thënë Cikaqi.

Bazuar në sipërfaqen e kultivuar me grurë dhe rendimentet mesatare, sipas të dhënave preliminare, Cikaqi ka thënë se sivjet Kosova do t'i plotësojë mbi 70 për qind të nevojave të popullatës me ushqim. Por, shifra krejt të tjera japin në Federatën Sindikale të Bujqve të Kosovës. Tahir Tahiri, kryetar i kësaj Federate, shprehet se janë të kënaqur me cilësinë e grurit gjatë këtij viti, por jo me sipërfaqen e mbjell. Pavarësisht kësaj, ai tha se Kosova nuk arrin as 40 për qind t'i plotësojë nevojat për ushqim nga rendimentet e grurit. "Edhe sivjet kemi pasur sipërfaqe të vogla të tokës së mbjell me grurë, kanë qenë mbi 40 mijë hektarë. Kështu që prapë jemi të varur nga importi për rreth 60 për qind të nevojave

të popullatës që i duhet Kosovës", ka thënë Tahiri.

Sipas të dhënave zyrtare, në Kosovë nevojat për këtë produkt për kokë banori janë 205 kilogramë, që i bie se në Kosovë duhet të harxhohen 410 mijë tonë grurë. Por, sipas një raporti të publikuar gjatë këtij muaji nga Ministria e Bujqësisë, i quajtur "Kultivimi i Grurit dhe Misrit në Kosovë 1939-2019, thuhet se gjatë vitit të kaluar sipërfaqja e kultivuar me grurë ka qenë rreth 80 mijë hektarë, kurse prodhimi nga këto sipërfaqe ishte 285 mijë tonë grurë. Pavarësisht kësaj, Kosova vazhdon të importojë sasi të mëdha të grurit dhe miellit nga vende të ndryshme të rajonit. Vetëm gjatë vitit të kaluar importi i grurit kishte sasi prej 120 mijë tonësh me një vlerë prej 24 milionë eurosh.



Hoti: Bizneset dhe qytetarët përfitojnë 470 milionë euro nga projektligji për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar se përfitimet për qytetarët dhe biznese nga Projektligji për rimëkëmbje ekonomike janë rreth 470 milionë euro. Sipas Hotit, në analizën që Ministria

e Financave i ka bërë këtij projektligji, që është në pritje për miratim në Kuvendin e Kosovës, rezultoni se përfitimet për qytetarët dhe biznese sivjet dhe vitin e ardhshëm janë rreth 470 milionë euro. "Ky vlerësim i efekteve ekonomike

dhe sociale është nxjerrë duke analizuar secilin nen të projektligjit. Këto mjete, së bashku me fondin prej 365 milionë eurosh për rimëkëmbje ekonomike që është pjesë e buxhetit për 2020 tanimë të miratuar, do t'i lehtësojë duk-

shëm pasojat e pandemisë për qytetarët dhe biznese. Është tepër me rëndësi që në seancën e parë në sesionin vjeshor të Kuvendit të miratohet ky projektligji", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook".

Kërkohet pezullimi i udhëzimit administrativ për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2020 për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve, i nxjerr nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar (KKRF), është kërkuar që të pezullohet për shkak të rrethanave pandemike dhe kostos shtesë për të bërit biznes në Kosovë. Sipas përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë, Arian Zeka, Berat Rukiqi, si dhe Skender Krasniqi, ky udhëzim, përpos që është barrë shtesë për bizneset, sidomos tani në kohë pandemie, është nxjerrë pa konsultim paraprak të partneritetit publiko-privat. Ata kanë kërkuar shterjen e zbatueshmërisë së këtij udhëzimi në bazë të rrethanave pandemike ose mbulimin e kostos së auditimit nga buxheti shtetëror



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 GUSHT - Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë dhe njohësit e çështjeve ekonomike e kanë konsideruar barrë financiare Udhëzimin Administrativ nr. 01/2020 për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve. Ky udhëzim është nxjerrë nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar (KKRF) më 10 shkurt të këtij viti dhe është obligues për pasqyrat financiare të periudhës kontabël 2010 e tutje. Sipas nenit 2, pika 1, "dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të obligueshme për shoqëritë tregtare të regjistruara në ARB dhe të klasifikuara si mikrondërmarrje sipas nenit 5, paragrafi 2, i Ligjit NR.06/ L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës dhe janë të obliguara sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim t'i përgatisin pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme".

Lidhur me këtë, drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo odë ka kërkuar nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar shterjen e zbatimit të dispozitave që kërkojnë nënshkrimin e pasqyrave nga kontabilistët e certifikuar pasi, sipas tij, një dispozitë e tillë do ta rriste ngarkesën financiare për bizneset e vogla në Kosovë. "Oda Ekonomike Amerikane ka kërkuar në janar të këtij viti nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar (KKRF) shterjen e zbatimit të dispozitave që kërkojnë nënshkrimin e pasqyrave nga kontabilistët e certifikuar meqë një dispozitë e tillë do ta rriste ngarkesën financiare për bizneset e vogla në Kosovë, dispozitë kjo që buron nga Ligji për Raportim Financiar. Aq më tepër kur tash e

disa muaj sektori privat po ballafaqohet me vështirësi të shumta si pasojë e kufizimit të aktivitetit ekonomik me qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19. Besoj fuqishëm që KKRF-ja do t'i ketë në konsideratë rrethanat e reja të krijuara pas shpërthimit të pandemisë dhe do t'i rekomandojë te Ministria e Financave që t'i iniciojë ndryshimet e nevojshme ligjore", ka thënë Zeka. Sipas tij, bazuar në kapacitetet financiare të ndërmarrjeve të vogla, kërkesa për auditimin e pavarur të pasqyrave financiare nga një auditor i certifikuar do ta rrisë barrën financiare për këto ndërmarrje". Duke i ditur kapacitetet financiare të ndërmarrjeve të vogla, kërkesa për auditimin e pavarur të pasqyrave financiare nga një auditor i certifikuar do ta rrisë barrën financiare për këto ndërmarrje", është shprehur ai. Zeka ka thënë se kërkesat për certifikime profesionale në këtë sektor në asnjë mënyrë nuk zhvlerësojnë edukimin universitar të profesionistëve të kësaj fushe. "Kosova në përgjithësi ka legjislacion të mirë që rregullon fushën e raportimit financiar, kontabilitetit dhe auditimit dhe i cili promovon standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, ndërsa kërkesat për certifikime profesionale në këtë sektor në asnjë mënyrë nuk zhvlerësojnë edukimin universitar të profesionistëve të kësaj fushe", ka deklaruar drejtori i OEAK-ut. Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se ky udhëzim përbën barrë për bizneset, e sidomos tani në kohë pandemie. Ai ka thënë se në këtë situatë ose duhet të shtyhet zbatimi i udhëzimit ose shërbimi të paguhet nga buxheti i shtetit. "Në përgjithësi në kemi kërkuar që të rritet cilësia e raportimeve financiare. Por, tani në pandemi

kjo krijon kosto shtesë për bizneset, sidomos bizneset e vogla e kanë të pamundur ta mbulojnë. Në këtë rast ose duhet të shtyhet zbatimi i udhëzimit ose shërbimi të paguhet nga buxheti i shtetit", ka thënë Rukiqi.

Ndërsa drejtori i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skender Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky udhëzim gërsheton edhe një barrë shtesë për bizneset dhe se një udhëzim i tillë nuk është i domosdoshëm. "Ky udhëzim na ngarkon me kosto shtesë dhe shteti duhet të mendojë për humbjet që na ka shkaktuar pandemia dhe këtu kemi të bëjmë me krijim të të hyrave për disa persona. Ne s'jemi assesi kundër çdo auditimi, mirëpo kjo kosto është ngarkesë me anë të së cilës shteti u ka krijuar barrë bizneseve. Nëse auditorët certifikohen nga shteti pse duhet të na vënë këtë barrë shtesë, pra obligim që nuk është i domosdoshëm", është shprehur Krasniqi. Sipas tij, mospërfillja e kërkesave dhe rekomandimeve nga spektri biznesor drejtuar Qeverisë së Kosovës është shqetësuese. "Ne kemi dërguar shumë kërkesa në Qeveri dhe Kuvend sa i përket ambientit biznesor, po ashtu edhe për Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike por, fatkeqësisht, kërkesat tona s'po përfillen", ka thënë ai.

Më tutje, njohësi i çështjeve ekonomike dhe ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, i cili është edhe sekretar gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, ka thënë se bizneseve në Kosovë është duke iu rënduar aktiviteti i tyre dhe se ato janë bërë viktimë e udhëzimeve administrative. "Është një dukuri mjaft negative që po e përcjell të bërit biznes në Kosovë, pasi

bizneset po bien viktimë të udhëzimeve të ndryshmeve administrative, të cilat po përpilohen dhe po dizajnohen nga njerëz të punësuar në institucionet shtetërore të cilët paguhet nga tatimpaguesit kosovarë e të cilët po punojnë dhe po krijojnë favore për grupe të caktuara të interesit", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se në kohë pandemie, në vend se të gjenden mekanizma për ta lehtësuar të bërit biznes në Kosovë, është duke ndodhur e kundërta. "Një barrierë e tillë nga ky udhëzim ka kaluar në heshtje dhe pa asnjë debat publiko-privat dhe vetëm me rekomandime të grupeve të caktuara të interesit. Edhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/2020 për raportimet financiare vjetore të mikrondërmarrjeve i obligon bizneset që të paguajnë një sasi bukur të madhe parash e që janë tri kategori që fillojnë me 500, 1 000 dhe 3 000 euro, që është vërtet një barrë e papërbalueshme për sektorin privat", është shprehur Gërxhaliu. I pyetur për ndikimin e këtij udhëzimi në luftimin e informalitetit, Gërxhaliu është përgjigjur se në Kosovë përdoren pretekte të ndryshme vetëm për ta rënduar të bërit biznes dhe favorizuar interesa të caktuara. "Në Kosovë përdoren pretekte të ndryshme për përfitime. Në qoftë se kemi një justifikim të tillë dhe kemi nënshkrimin e auditorit të akredituar pse duhet gjithsesi të shkohet dhe të kontrollohet edhe një herë. Është e rrugës të jenë çmime më të ulëta, e jo të paguhet deri në 3 000 euro, kur mund të jetë një kosto më e ulët. Prandaj, konsideroj se është një barrë. Ministria e Financave dhe kabineti qeveritar duhet ta shqyrtojë me urgjencë këtë udhëzim", u shpreh ai.

Më tutje, Alban Hashani nga

Instituti "Rinvest" ka thënë se përpjekjet për ta përmirësuar raportimin financiar janë të mirëseardhura por, sipas tij, duhet rritur konkurrenca në sektorin e auditimit gjë që do ta ulte fuqinë tregtare të auditorëve individualë, rrjedhimisht edhe çmimin. "Mendoj se përpjekjet për ta përmirësuar raportimin financiar janë të mirëseardhura. Në këtë kuadër edhe udhëzimi administrativ i cili mund t'i qartësojë hapat se si duhet të zbatohet legjislacioni për raportim financiar është i mirëseardhur, për shkak se është një treg i rregulluar, autoritetet që sigurojnë konkurrencë duhet të sigurohen se parimet e ekonomisë së tregut të lirë nuk po cenohen. Megjithatë, duhet rritur edhe konkurrenca në sektorin e auditimit gjë që do ta ulte fuqinë tregtare të auditorëve individualë dhe, për pasojë, edhe çmimin", ka thënë Hashani. Po ashtu, ai ka thënë se trajnimet shtesë në këto profesione janë të domosdoshme. "Jo detyrimisht vihet në pikëpyetje shkollimi universitar. Gjithkund nëpër botë profesionistët e auditorit është profesion i rregulluar; ku hyrja në këtë profesion është e kushtëzuar me certifikim. Për rrjedhojë, trajnimet shtesë në këto profesione janë të domosdoshme. Atë çka mund të bëjnë universitetet është që të bashkëpunojnë me institucione që licencojnë auditorët /kontabilistët që të harmonizohen një pjesë e provimeve të cilat mund të njihen nga këto institucione. Kjo do ta lehtësonte punën e secilës palë", ka deklaruar ai. Lidhur me këtë çështje, gazeta "Epoka e re" më 14 gusht ka dërguar disa pyetje te Ministria e Financave për të marrë përgjigje nga Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

Inaugurohet projekti i zgjerimit të rrugës në qendër të Gjilanit

GJILAN, 30 GUSHT - Është inauguruar të dielën në Gjilan pjesa e tretë e rrugës në qendër, përkatësisht në bulevardin "Ibrahim Rugova", që është një nga projektet më të mëdha infrastrukturore në këtë komunë.

Në inaugurim ka marrë pjesë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, me bashkëpunëtorë, ministri i Infrastrukturrës, Arban Abrashi dhe zëvendësministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Rexhep Kadriu. "Jemi në

bulevardin 'Ibrahim Rugova', në të cilin janë të integruar tri sheshe të mëdha të Gjilanit, në kuadër të rigjenerimit urban të zonës së parë të qytetit. Projekti i filluar para disa vitesh po merr formë. Do të vazhdojmë në pjesën tjetër të zgjerimit dhe standardizimit prej sheshit 'Rexhep Mala e Nuh Berisha', 'Kadri Zeka' deri te lapidari i Abdullah Tahirit. Rigjenerimi parasheh fazën e dytë në vitin e ardhshëm, ku përfshihet integrimi i rrugëve kryesore

'Madeline Albright', 'Adem Jashari' e 'Mulla Idriz Gjilani'", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se ky projekt ambicioz e përkthen Gjilanin si zonë urbane në programin 2020-2025, si një nga qendrat ku njerëzit dhe zhvillimi i ekonomisë janë prioritet.

Ndërsa ministri i Infrastrukturrës, Arban Abrashi, ka thënë se vëmendja e Qeverisë së Kosovës për projektet zhvillimore në Anamoravë po koncentrohet gjithnjë e më shumë në Gjilan.



Zbukurohet Prishtina

PRISHTINË, 30 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se për të tretën herë radhazi kryeqyteti i Kosovës është nikoqir i artistëve ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët janë pjesë e Festivalit "Meeting of Styles",

i cili është duke u zhvilluar në hyrje të qytetit nga Fushë-Kosova. Me këtë rast, Ahmeti ka falënderuar organizatën joqeveritare "Q'art" për organizimin e këtij festivali, i cili është duke sjell plot ngjyra. "Për të tretën herë radhazi qyteti ynë është nikoqir i artistëve

ndërkombëtarë e vendorë që janë pjesë e Festivalit 'Meeting of Styles' që po zhvillohet në hyrje të qytetit nga Fushë-Kosova. Falënderojmë OJQ 'Q'art' për organizimin e festivalit që po sjell plot ngjyra në këto ditë plot sfida për të gjithë!", ka thënë Ahmeti.

Kryetari i Ferizajt: Projekti "Bashkimi i Qytetit" po bëhet

FERIZAJ, 30 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se projekti "Bashkimi i Qytetit" është duke vazhduar të realizohet. Ai ka thënë se për realizimin e këtij projekti madhor kanë vetëm edhe 30 për qind të punimeve pa realizuar. "Ditë pas dite, 30 për qind e mbetur e punëve po ngrehet mu në zemrën e Ferizajt, kryevepra infrastrukturore 'Bashkimi i Qytetit',

halkë kjo më e madhja e më me peshë në zinxhirin e gjatë të transformimit infrastrukturor që po bëjmë çdo ditë të punës sonë, përgjatë gjithë trupit të qytetit e fshatrave. Pamje nga puna pa pushim, në kantierin që me çdo goditje gozhide po e bën më të afërt e të prekshëm transformimin, identitetin e ri të Ferizajt, që më shumë se gjithçka e meriton Ferizaj e ferizajasi", ka thënë Aliu.



Në fshatin Mirushë rregullohen dy rrugë të reja

MALISHEVË, 30 GUSHT (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në vendbanimet e Komunës së Malishevës, edhe në fshatin Mirushë është duke u punuar në rregullimin e dy rrugëve brenda fshatit. Punimet në këto rrugë i ka inspektuar drejtori komunal për Urbanizëm, Ahmet Morina, së bashku me kryetarin e fshatit, Urim Thaçi.

Drejtori Morina gjatë inspektimit në këto rrugë është njoftuar në tërësi me ecurinë e punimeve, si nga ana e operatorit, ashtu edhe nga

zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen e punimeve, por edhe nga kryetari i fshatit, në mënyrë që punimet të kryhen sipas kontratës dhe sipas kriterëve të parapara.

Drejtori Morina ka thënë se deri më tani është i kënaqur me ecurinë e punimeve dhe zbatimin e planit dinamik sa i përket infrastrukturës rrugore. Ndërsa kryetari i fshatit Mirushë, Urim Thaçi, e ka falënderuar Komunën e Malishevës për këtë investim, pasi të dyja rrugët kanë rëndësi të madhe për banorët që jetojnë në këtë pjesë të fshatit.



ZOTËRI MARTY, KENI URREJTJE TË PAKUFISHME PËR LUFTËN ÇLIRIMTARE DHE UÇK-në (40)



Shkruan: Kudusi LAMA

Duke lexuar pikat 105, 106, 107, kuptoj se ju flisni me hamendje, ose keni manipuluar me biseda të ndryshme të improvizuara ose të komunikuar me individë që mund të mos kenë asnjë lidhje me strukturat e UÇK-së, të cilët mund të flasin me çfarë mund të kenë dëgjuar se ku kanë qenë qendrat e grumbullimit e të stërvitjes të furnizimit të UÇK-së, ku pastaj ju, duke manipuluar, keni shtuar shprehje konkludimi imagjinari, si: “Vendet e burgimit ku do kenë ndodhur këto “marrje në pyetje” – konkretisht ato më pranë kufirit me Kosovën – ishin njëkohësisht “baza” apo “kampe” ushtarake – vende stërvitjeje nga ku dërgoheshin në front luftëtarë apo furnizoheshin me armë e municione”. Pra, ju, duke kuptuar se diku ka pasur një bazë grumbullimi, stërvitjeje e furnizimi luftëtarësh të UÇK-së, arrini të arsyetoni se meqë ishin kampe ushtarake, duhet të ketë pasur edhe burgje. Ky deklarim, sipas asaj çfarë kuptoj unë nga të drejtat e ushtrimit të detyrës, është shpërdorim detyre. Nëse do të ishit vartësi im, do t’ju kisha shkarkuar nga detyra për këtë mënyrë të shprehuri dhe për këtë mënyrë trajtimi të çështjeve të tilla që konsiderohen shumë të rëndësishme, por që ju i trajtoni duke i shikuar nga këndvështrimi paragjykses, dukuri që nuk i lejohet një diplomati e politikani të bashkësisë ndërkombëtare, siç jeni ju, që flisni në emër të Evropës. Ose “në shumicën e rasteve, robërit do jenë mbajtur mënjatë operacioneve që mund të klasifikohen si klasike në kohë lufte, dhe nga ana tjetër shumë larg syve të shumicës së luftëtarëve të UÇK-së e të vëzhguesve të jashtëm që mund të kenë vizituar këto baza”. Kur ju që pretendoni se i njihni këto baza, duhet të thoni se si mund të bëhen veprime kriminale në ato hapësira, e të mos shikohen apo dëgjohen nga luftëtarët. Duket sikur për ju luftëtarët janë kukulla e jo njerëz me logjikë e me arsye që nuk janë pa dëgjim e pa shikim si gjithë njerëzit e tjerë. Zotëri, në hapësirat e bazave të UÇK-së nuk ka asnjë mundësi të bëhen veprime të fshehta, por aty ka pasur


komandantë që i kanë kontrolluar dhe disiplinuar ato baza sipas rregullave të shkruara që ka pasur UÇK-ja si në çdo ushtri tjetër. E për çudi, ju konstatooni se nëpër këto baza janë bërë veprime kriminale nga njerëz që nuk kanë qenë në përbërje të bazave dhe që komandantët e bazave nuk kanë ditur se ç’po ndodh. Sipas arsyes logjike të një njeriu të rritur e të shëndoshë mendërisht a mund të ndodhë një gjë e tillë? Këdo që të pyesësh do të japë përgjigjen e thjeshtë, jo. Por ja që është dikush, i cili siç njeht fushën e krimeve, njeht edhe rregullat e disiplinës ushtarake e të menaxhimit të kazermave, njeht edhe rregullat e luftës, e ky njeri qenkeni ju zotëri Marty. Është shumë interesante por ja që është e vërtetë, që ju mund të merrni përgjegjësi dhe të bëni ekspertin paragjykses për gjithë veprimtarinë e luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në pikën 108 ju flisni për transportimin dhe mbajtjen në burgje në Shqipëri të robërve të luftës, që duket si një diçka e veçantë, por do të kisha dëshirë të flasësh me emrat dhe të marrin përgjigje pyetjeve: Sa robër lufte paska transportuar UÇK-ja në Shqipëri? Cilët janë ata? Si i kanë emrat? Ku janë zënë robër, në cilin front? Çfarë njësie ushtarake i takojnë? Meqenëse janë kthyer në shtëpi siç pretendoni ju, prej nga janë dhe ku janë aktualisht? Zotëri Marty, për robërit e luftës flitet duke u dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme, nuk mund të flitet për robër lufte sikur ata janë pako mallrash të përdorura. Ashtu siç shpreheni edhe për të arratisur nga këto burgje, po pse nuk i prezantoni mor zotëri që t’u nxirrni bojën atyre që i kanë mbajtur të burgosur? Po të ishte e vërtetë një gjë e tillë do të kishit një element të fortë në dorën tuaj për të justifikuar këtë deklarim tuajin. Por ju thjeshtë vetëm keni dëshirë të ilustroni akuzën dhe nuk keni mundësi të shkoni më tej. Ashtu sikurse në vazhdim në pikën 109, thoni se “Jemi vënë në dijeni të ekzistencës së personave të mbijetuar...”, për të cilët gjithashtu thoni se paskan dëshmuar për krimet në Cahan, Kukës e Durrës, gjë që tregon edhe njëherë formalitetin e raportit tuaj, pasi ju thjeshtë jeni vënë në dijeni, por nuk dini të vërtetën, ç’ka më jep të drejtën mua të mendoj se ju thjeshtë jeni marrë me thashetheme dhe edhe raporti juaj nuk është tjetër veçse një sistemim thashethemesh dhe shpifjesh sipas një skenari serb, duke renditur të gjitha informacionet

mashtuese që janë publikuar me kohë në deklarinimin e librave që janë shkruar nga serbët sipas një programi shtetëror për atë periudhë. Por ajo që më bën të kthej gjithnjë vështrimin nga ju, është fakti që në raportin tuaj po të thuhet se diku ka qenë një bazë e UÇK-së, ju menjëherë i vini etiketën “bazë kriminale”, këtë me sa duket e bëni sepse për shqiptarët dhe të drejtat e tyre dhe për Luftën Çlirimtare të Kosovës e UÇK-në keni urrejtje të pakufishme. Të punosh për dikë se të paguan, siç keni punuar ju për Serbinë është e arsyeshme, por të kesh urrejtje patologjike ndaj atyre që akuzon e për të cilët shpif, do të thotë se këtu ka edhe diçka shpirtërore. Jam kurioz të di pse e keni këtë urrejtje patologjike për shqiptarët? Nuk besoj se keni pasur ndonjë marrëdhënie konfliktuale me shqiptarët personalisht. Pse pra? Se në raport duket, sikur ju e keni personalizuar problemin, duke e kthyer në një marrëdhënie personale mes jush dhe shqiptarëve. Ju nuk ndaleni në akuza zotëri Marty dhe nuk ndaleni edhe kur tentoni të futni konflikt brenda kombit shqiptar. Por ju gaboni zotëri, se shqiptarët në gjithë historinë e tyre nuk kanë asnjë moment lufte civile, me gjithë përpjekjet që kanë bërë armiqet për ta krijuar mundësinë që të konfliktohen midis tyre, siç po bëni edhe ju me raportin tuaj. Kështu mund të thuhet edhe për FARK-un, për të cilin ju flisni në pikën 111, por nuk dini se ministri i mbrojtjes i qeverisë së Kosovës në ekzil nën kryeministrin Bujar Bukoshi, i cili ka deklaruar në intervistë televizive, se FARK-u ishte ngritur si strukturë nga qeveria që me krijimin e saj, i cili megjithëse nuk e mori dot kontrollin asnjëherë për t’u bërë funksional dhe veprues, forcë kryesore do të kishte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa ju e nxirrni FARK-un si forcë opozitare e UÇK-së. Ju arrini deri atje sa të përcaktoni se: “Grupi ushtarak i pagëzuar Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës, apo FARK, luftonte zyrtarisht për çlirimin e Kosovës ashtu sikurse UÇK-ja, por komandantët e kësaj të fundit e trajtonin me përbuzje e dyshim, si një kundërshtar. FARK-ët, politikisht të përafërt me LDK-në, konsideroheshin si krahu i armatosur i qeverisë në mërgim të Bujar Bukoshit. Në të kundërt të UÇK-së, FARK-ët u formuan nisur nga një bërthamë oficerësh me përvojë të dalë nga etnia shqiptare dhe që kishin

shërbyer në Ushtrinë federale jugosllave. Komandantët e UÇK-së i shihnin me shumë dyshim FARK-ët dhe përpjekshin t’i pengonin në rekrutimin e luftëtarëve të rinj dhe në furnizimin me armë e municione. UÇK-ja ka mbajtur të burgosur shumë persona, sidomos civilë me origjinë nga Kosova, në Veri të Shqipërisë, pranë kufirit me Kosovën, persona që ajo i akuzonte se mbështesnin FARK-ët dhe se nuk tregoheshin të ndershëm ndaj kauzës së UÇK-së”. Pse e bëni këtë akuzë zotëri Marty, kush u ka thënë se ka pasur një konflikt midis UÇK-së dhe FARK-ut, që paska arritur deri në veprime që i përmendni ju. A mundeni ju t’i rreshtoni këto dy ushtri e t’i merrni në evidencë të na i tregoni ndarjet edhe ne shqiptarëve se nuk i dimë? Hajde zotëri Marty na e tregoni historinë tonë se ju jeni vërtetë i gjithanshëm dhe i gjithëdijshëm. Por shqiptarët kanë një fjalë të artë që thotë: Qesh ai që qesh i fundit. Në pikën 113, ju kaloni në akuza të drejtpërdrejta për individë duke u shprehur: “Sabit Geci, Riza Alija (alias “komandant Hoxhaj”) dhe Xhimshit Krasniqi figurojnë ndër komandantët e UÇK-së të akuzuar se kanë qenë në krye të këtyre qendrave të burgimit. Këta tre persona zënë një vend të rangut të parë edhe në hetimet e mëparshme çelur nga UNMIK-u lidhur me krimet e luftës të kryera në Veri të Shqipërisë; tashmë po i nënshtrohen një hetimi nga ana e Hetuesisë së posaçme të Kosovës dhe së shpejti duhet të gjykohen nga gjykata e shkallës së parë të Kosovës; pasuritë e tyre të patundshme janë bllokuar plotësisht”. Nuk pretendoj të shfaqësoj askënd, në qoftë se ka bërë faje, por fakti që përmendet Sabit Geci dhe Xhimshit Krasniqi së bashku, më duket se është problem i pa gjetur. Që këta të dy luftëtarët e përmendur kanë qenë luftëtarë të spikatur në luftën kundër pushtuesit këtë e konfirmoj me zë të lartë. Por që këta në atë periudhë lufte të kenë gjetur kohë të merren me burgime e tortura këtë nuk mund ta kuptoj dhe nuk do ta kuptoj kurrë, sepse ata di që i donin njerëzit dhe për mbrojtjen e jetës së tyre kishin vite që luftonin në male kundër kolonizatorit. Së dyti, Sabit Geci ishte i plagosur rëndë dhe lëvizte me shumë vështirësi me ndihmën e patericave. Mendoj se nuk kishte asnjë mundësi të merrej me torturime, pasi atë e ndihmonin shokët edhe në rrugë për të lëvizur. Nuk dua të besoj se këtë

gjendje shëndetësore Sabiti e kishte false për të fshehur atë që ia keni zbuluar ju zotëri Marty. Së treti, Sabit Geci me gjithë plagët e rënda që kishte, diku nga prilli i vitit 1999, u aksidentua rëndë me makinë në malin e Dajtit mbi Tiranë, duke thyer disa brinjë dhe deri në gusht 1999 ka qenë në spitalin e Saukut, në Tiranë, në gjendje të rëndë, që nuk ka mundur as të lëvizë nga vendi pa ndihmë. Se si paska arritur ky njeri të merret me veprime kriminale në gjithë ato qendra që përmendni ju këtë nuk e kuptoj. Njëkohësisht vlerësoj se Xhimshit Krasniqi e njoh mirë dhe di që është luftëtarë i pazëvendësueshëm. Por që ai gjatë gjithë kohës të jetë marrë me këto çështjet e torturave, e arrestimeve, siç thoni ju, nuk mund ta besoj, pasi ka pasur mjaft detyra të tjera për të kryer. Së dyti, në atë kohë detyrat kanë qenë të ndara dhe nuk mund të lëvizte luftëtarë nga të kishte dëshirë. Luftëtarë kishte një hapësirë të caktuar veprimtarie. Kështu që Xhimshit Krasniqi i ngarkuar me detyrë në Kukës, nuk mund të lëvizte prej andej sepse kishte dinamikën e punës të ngjeshur dhe nëse do të thyente disiplinën jepte llogari për mangësitë që i krijoheshin në furnizimin e luftëtarëve në front, pasi ky ishte misioni i tij. Ai ishte caktuar me detyra logjistike. Së treti, edhe në Kukës Xhimshiti nuk ka pasur asnjë të drejtë në qendrën e Kukësit, pasi atje ishte dikush tjetër komandant dhe edhe po të donte të hynte nuk e linin të hynte, pasi nuk ishte pjesëtar i asaj kazermë dhe nuk kishte detyra të ishte atje. Ndërsa në bazat e tjera në Durrës a diku tjetër nuk kishte mundësi praktike të shkonte. Nisur nga të gjitha këto që shpjegova më lart praktikisht e vlerësoj të pamundur që Xhimshiti të kishte kohë të merrej me veprime të tilla të burgimit e të torturimit apo të transportit të të burgosurve, për faktin se në atë kohë ishte vështirë të gjendeshin automjete për të dërguar materiale drejt frontit që kishte shumë nevoja, jo të gjendeshin makina për veprime të tilla. Megjithatë edhe për këta të dy luftëtarët e përmendur vlerësoj se ju zotëri Marty keni marrë të dhëna sipas literaturës dhe instruktimit serb, për të cilat kam bërë evidencimet e gjetura dhe ju besoj i keni parë edhe në këtë reagim, por edhe më herët, pasi i keni shfrytëzuar, ose ua kanë dhënë të gatshme, siç kam krijuar bindjen unë, bindje të cilën e kam shprehur më shumë se njëherë. (Vijon)

Një komerdare logjike për ata që duan të dalin nga loja e detit, dy fjalë për Greqinë dhe një vath në vesh nga unë për ju



Shkruan: Edi RAMA

Padija nuk është faj, askush nuk i di të gjitha dhe sa të rrosh do të mësosh, thotë populli. Faj është ta ushqesh padijen, ta shfrytëzosh padijen, ta ushtrosh padijen si armë ndaj tjetrit.

Shoh që vazhdojnë disa të shajnë e të mallkojnë, lidhur me "shitjen" e detit dhe meazallah se kanë pykë, kur u thua nuk ekziston as shitja, as falja, as vetë marrëveshja për detin! Disa prej tyre që sytë e veshët i kanë top, por që ua mban mbyllur mendja e mblodhur top me litarët e opozitës sonë në krizë për mend, janë të pakurueshëm. Disa të tjerë janë sinqerisht të shqetësuar për këtë çështje, megjithëse e kemi sqaruar që nuk ka asnjë arsye për shqetësim. Të parëve s'kemi ç'u bëjmë, nuk duan të dëgjojnë, të lexojnë, të kuptojnë. Të dytëve po u ridrejtohem, me shpresën që do mund të dalin nga dallga artificiale e kësaj loje të ulët politike!

Për kufijtë mes dy shteteve s'mund të ekzistojë asnjë marrëveshje e fshehtë. Nuk bëhen marrëveshje të fshehta për këtë punë, sepse s'kanë asnjë vlerë mbi tokë e as mbi det, për sa kohë janë të fshehta. Bëhen marrëveshje të negociuara me vite, të cilat emrin marrëveshje e marrin kur bëhen publike dhe vlerën si marrëveshje e marrin vetëm kur kalojnë provën e institucioneve kushtetuese të shtetit. Prandaj marrëveshjet nuk merren vesh me telefonin e prishur të thashethemet të radhës, që shumëzohet në gojën e politikanëve pa atdhe apo në detin e internetit pa kufij, po vetëm kur shihen me sy, me lexim, bashkë me firmat e me vulat e tyre!

A keni parë ndonjë dokument të firmosur e të vulosur për këtë detin që paskam dhënë, shitur a falur unë? Jo nuk keni parë! Sepse nuk ka dhe s'ka se si të ketë. Po të kishte do të dilte, por s'mund të dalë gjëkund asnjë marrëveshje e tillë me firma e me vula, që unë nuk e di apo që unë mund ta mbështes, nëse çon interesin kombëtar të Shqipërisë! Kush e luan me ju këtë lojë do që t'ju bëjë për budallenj, tallet paturpësisht me ndjenjat tuaja për të përfituar politikisht prej çoroditjes që synon t'ju shkaktojë, duke ju prekur ndjenjat.

Sa për kujtesë isha unë në krye të opozitës, kur çova në Gjykatën Kushtetuese, një marrëveshje të mëparshme, për kufijtë detarë me Greqinë, të firmosur e të vulosur nga Lulëzim Basha, me bekimin e me mbrojtjen publike të Sali Berishës e të Ilir Metës. Sipas meje

ajo marrëveshje cenonte interesin kombëtar. Po jo se ashtu ma thoshte mendja mua, por sepse kështu e gjykoj një ushtarak patriot si Myslim Pasha, i cili e ngriti publikisht e profesionalisht shqetësimin mbi çfarë kishte firmosur fiks i njëjti Lulëzim, po ky Lulëzim që sot merret me thashetheme të ulëta për të kapur në detin e paditurisë ndonjë sardele më shumë, për tiganin e fërteleve të opozitës.

Dhe unë, që atëherë isha krejt i paditur për të Drejtën e Detit, mblodha ekspertët, dëgjova sa munda, hapa librat, mësova sa munda, e së bashku me të tjerë, vendosa ankimmimin e asaj marrëveshjeje në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata e rrëzoi marrëveshjen e Lulëzimit, Salit dhe Ilirit, me rezultatin kuptimplotë 9 me 0. Pikërisht sepse cenonte interesin kombëtar. Por ama ne çuam në gjykatë një dokument shtetëror, jo një thashetheme digjitalë për tradhti kombëtare dhe nuk hapëm një gjyq publik logjesh nacional-folklorike rrugëve, po një gjyq serioz në nivelin më të lartë të pushtetit gjyqësor.

Sot po këta që e bënë atë marrëveshje antikombëtare dhe e futën edhe detin në çorbën e Shqipërisë që qeverisën, prej padijes së tyre të dhimbshme a prej shpërfilljes sportive të interesit kombëtar ose të dyjave bashkë, kanë kapur kallamat me dorë e kanë dalë për gjahun politik të radhës.

Për të mbrojtur detin nga unë!

O Zot!

Duhet të jesh peshk i trullësor komplet që ta hash karremin e Lulëzim Bashës, Ilir Metës dhe Sali Berishës (shyqyr Monika ia ka lënë Peço peshkatarit grepin këtë herë, se është e zënë me skuqje karkalecash me muzikë Desperado:-), të cilët po mbrokan sot nga unë detin që e kanë zakon ta bëjnë kos e dhallë, sa herë zënë dybekun e pushtetit me dorë. Megjithatë, fatkeqësisht, u ka zënë grepi gjithnjë peshq të trullësor dhe s'kanë faj që vazhdojnë ta hedhin përditë në detin e muhabetit publik, karemin e politikës së tyre pa din e as iman.

Njësoj si më parë, kur ministri i jashtëm grek foli andej në një televizion, për ushtrimin e të drejtës së Greqisë për t'u shtrirë në miljet e famshme, që Konventa Ndërkombëtare e të Drejtës së Detit ia njeh çdo shteti me dalje në det dhe këtu plasi peshku me dinamitin e luftës politike, edhe sot përsëritet e njëjta poshtërsi ndaj publikut shqiptar pasi kryeministri i Greqisë thotë të njëjtën gjë në parlamentin grek, pas firmosjes së marrëveshjeve detare të shtetit të tij me Italinë dhe Egjiptin.

Plas dinamiti i politikës së trullësjes

të shqiptarëve në pellgun e llokoçitjeve opozitare dhe pllaf, pllaf, dalin me barkun jashtë në sipërfaqe peshqit e urrejtjes nacionaliste, të mllëfit partiak e të paditurisë për temën, duke krijuar një tollovi absurde si sherret e rakisë në klubin e fshatit. Si zakonisht në këto raste, sado të flasësh me logjikë, pa dalë rakia s'ka shans të mbarojë tollovia! Po le të kthehemi tek marrëveshja në fjalë mes Shqipërisë e Greqisë, për ta ndihmuar daljen e rakisë dhe hequr dhimbjen e kokës së atyre që duan të kuptojnë.

Kush do vërtetë të dëgjojë dhe të kuptojë si qëndron e vërteta e kësaj historie, le të më ndjekë me vëmendje sepse fatmirësisht, është shumë e thjeshtë.

Fjala e kryeministrit grek në parlament, siç e kam shpjeguar më parë, nuk ka asnjë lidhje me ujërat territoriale të Shqipërisë, me ndonjë marrëveshje mes Greqisë dhe Shqipërisë apo me ndonjë punë të Shqipërisë që lidhet me të drejtën e vendit fqinj për ato 12 miljet e stërpërfolura, sikur të ishin 12 kamiona me ujë deti që unë i paskësua kaluar fshehurazi në shtetin fqinj.

E drejta e 12 miljeve buron nga Konventa Ndërkombëtare e të Drejtës së Detit dhe Greqia nuk ka kufij detarë vetëm me Shqipërinë, po edhe vende të tjera, kështu që kryeministri grek është në të drejtën e vet kur flet në parlamentin e tij, për detet e Greqisë. Ndërkohë, për sa i përket deteve tona, Shqipëria e ka ushtruar në vitin 1990 të drejtën e saj të shtrirjes në ato milje, në bazë të asaj konvente ndërkombëtare të vitit 1982. Zgjerimi i bërë nga Shqipëria në marsin e 1990-ës është depozituar në Kombet e Bashkuara dhe as është kontestuar, as mund të kontestohet nga Greqia.

Por kjo mbase është shumë teknike për disa që vazhdojnë të mbrojnë detin e Shqipërisë nga fjala e kryeministrit të Greqisë, megjithëse e kemi shpjeguar disa herë, që deti nuk ndahet me gardhe si parcelat në fshat, po ka edhe hapësira të ndërmjetme ujërash ndërkombëtare mes "parcelave" ujore të çdo shteti. Kështu që po ju shpjegoj, informoj, sqaroj edhe njëherë, se Shqipëria dhe Greqia nuk kanë arritur asnjë marrëveshje për përcaktimin e dakordësuar të kufijve detarë mes tyre.

Unë dhe kryeministri i Greqisë, Kiriakos Micotaqis, nuk kemi folur ende për këtë çështje, as kur jemi ulur në takimin e parë në Nju-Jork, as kur jemi ulur në takimin e dytë në Athinë dhe as në ndonjë rrethanë tjetër, kur jemi takuar në këmbë apo kemi komunikuar në telefon - njëherë pas tërmetit të 26 nëntorit, kur ai është treguar një mik shumë i çmuar i Shqipërisë dhe ka kontribuar me gjithë zemër për operacionet e shpëtimit të

jetëve nën rrënoja. Dhe herën tjetër kur kemi këmbyer opinionet për masat kundër Covidit.

Qeveria jonë dhe qeveria greke nuk kanë biseduar asnjëherë dhe nuk kanë këmbyer asnjë opinion për këtë çështje, qysh se në krye të punëve në Greqi ka ardhur zoti Micotaqis. Negociatat për arritjen e një marrëveshjeje për të ashtuquajturin delimitim të ujërave mes Shqipërisë e Greqisë, i kemi zhvilluar me qeverinë e mëparshme greke dhe marrëveshja nuk është arritur të mbyllet, pavarësisht progresit të konsiderueshëm nga pika zero ku jemi rinisur pas rrëzimit nga Gjykata Kushtetuese, të asaj marrëveshjes së nënshkruar jo nga unë, po nga ata që sot po e mbrojnë detin nga unë.

Ne duam ta arrijmë një marrëveshje me Greqinë për këtë çështje, siç kemi arritur edhe të tjera e siç duhet të arrijmë të tjera akoma. Ne Greqinë e konsiderojmë një nga tre partnerët strategjikë më të afërt të Shqipërisë, së bashku me Italinë dhe Turqinë. Ne nuk kemi pretendime territoriale ndaj Greqisë dhe Greqia nuk ka të tilla ndaj nesh (përtej klubeve respektive dhe primitive të peshkatarëve që gjuajnë për trupeshq, me karremin e nacional-folklorizmit nëpër harta gjoja kombëtare po në fakt thjesht elektrorale), por ne kemi pretendime reciproke për bashkëkombësit që jetojnë në shtetin tjetër, të cilëve së bashku, të dyja qeveritë, me dialog konstruktiv e mirëkuptim njerëzor në radhë të parë, duhet t'u bëjmë pa pushim hyzmet të posaçëm për të drejtat e tyre.

Ne jemi fqinj të shkëlqyer në nivelin e marrëdhënies mes popujve, por s'kemi shkëlqyer gjithnjë në marrëdhëniet politike mes shteteve e qeverive. S'kemi ditur gjithnjë në dekadat para e pas vitit 1990, as ne e as grekët, ta vëmë politikën në shërbim të miqësisë mes popujve tanë dhe të mos bëjmë politikë ditore me historinë në kurriz të tyre. Sot marrëdhëniet mes dy qeverive në Athinë e në Tiranë, janë të mira dhe kanë një potencial të madh për t'u bërë të shkëlqyera. Unë punoj për këtë qysh nga dita e parë si kryeministër, ama pa ngurruar ta ngre zërin kur e kërkon interesi i Shqipërisë dhe duke besuar që zërimi i problemeve me fqinjët nuk vjen nga heshtja për problemet mes fqinjësh. Dhe ndjesia ime e fortë është që edhe kryeministri Micotaqis po punon për këtë, qysh ditën që hyri në zyrën e tij. Natyrisht, nga e thëna në të bërë është në mes një deti të tërë, por po përparojmë duke lundruar në ujërat e dëshirës reciproke për mirëkuptim, bashkëpunim, sukses për popujt tanë.

Po shtoj këtu edhe një detaj teknik,

por kuptimplotë. Grupi ynë negociator për çështjen e detit ka nevojë për ndryshime, pasi disa anëtarë të tij janë larguar nga pozicionet që mbulonin kur janë zgjedhur në grupin negociator. Këto ndryshime do të bëhen nëse do të rinisin negociatat dhe këto ndryshime nuk bëhen pa miratimin nga Presidenti të anëtarëve të rinj - jashtë grupit negociator askush, as kryeministri, nuk negocion dot asgjë dhe nuk shet e as blen dot asnjë liter ujë deti. E dyta, çfarëdo marrëveshje që arrihet në nivelin e grupit negociator, duhet të marrë miratimin e Presidentit, i cili ka thënë se marrëveshjen e mundshme do t'ia çojë Gjykatës Kushtetuese. Dhe e treta, marrëveshja që të marrë vlerë përfundimtare, shkon në parlament për të marrë vulën përfundimtare të Sovranit.

Kështu që, u them atyre që vjellin këtu, gjynah i madh të villni nga rakia e pështirë e ca xhagajdurëve që duan t'ju buçasë koka nga sekëllidia, prandaj vërvani gishtin kokës e lëruani rakinë në dorë dhe le ta përdorin po të duan për të larë xhamat e Shqipit!

Miq!

Mbajeni vath në vesh dhe as kur ju bie në kokë rakia e pështirë e fuçive politike e mediatike mos e vini kurrë në dyshim, se nuk bën dot vaki që unë të tradhtoj amanetin e katragjyshërve e stërgjyshërve të mi, nga gjaku familjar apo nga gjaku shpirtëror; as amanetin e Kristaq Ramës së parë, stërgjyshit tim që shkriu pasurinë për hapjen e shkollave shqipe dhe nënshkroi në Durrës pavarësinë e Shqipërisë; as amanetin e Odise Kasnecit, stërgjyshit të Anetës dhe mikut për kokë të Abdyl Frashërit, që ishte anëtar i Lidhjes së Prizrenit dhe u vra si përhapës i gjuhës shqipe nga një komando ekstremistësh grekë të asaj kohe; as amanetin e atij Plakut të Vlorës, që e mbaj mbi kokë çdo ditë në zyrën time, as amanetin e Imzot Nolit, që më mësoi shqipen e gjuhës e as atë të Faik Beut, që më mësoi shpatën e gjuhës dhe as, as, as... me radhë se janë shumë që t'jua numëroj këtu. Tani ata që nuk heqin dot dorë nga ajo raki e pështirë, le të vazhdojnë të pinë e le t'i vjellin sa të duan tapat e trurit në detin e internetit! Prodhuesve të asaj rakië do t'u vijë prapë shpejt radha e gjykimit nga populli, bashkë me faturën e kripur për palaçollëqet e tyre siç u erdhi në vitin 2017. Unë do të vazhdoj të bëj sa të mundem gjithçka duhet bërë, në respekt të amanetit të atyre pleqve që përmenda më lart dhe në shërbim të këtij vendi e të këtij populli.

Ndërsa Madhëria e Saj, Koha, do t'i verë të gjitha në vendin e tyre dhe do të tregojë se ku e ka vendin gjithkush në historinë e këtij vendi.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]


- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Toka nuk ka shumë kohë që është krijuar

Zemra e Tokës është e re. Është krijuar një miliard vjet më parë bërthama e saj e brendshme, që përbëhet nga hekuri në gjendje të ngurtë, duke e bërë fushën magnetike edhe më të fuqishme. Sipas studimeve të një grupi ndërkombëtar ekspertësh të kryesuar nga Universiteti i Teksasit, mendohet se Toka është krijuar 3 miliardë vjet më



parë, por brendësia e saj ka përfunduar krijimin vetëm para rreth 1 miliard vjetësh. Njeriu ende nuk e ka eksploruar thellësinë e plan-

etit tonë dhe dimë pak mbi këtë. Por, në bazë të studimeve dhe krijimit të kushteve fizike që mendohet se janë, konkluzioni është i saktë. Kërkuesve u janë dashur dy vjet për t'i rikrijuar në laborator kushtet e thellësisë së Tokës, ku mendohet se presioni është mbi 1 milion atmosferë dhe ku temperatura mund të krahasohet me atë të sipërfaqes së Diellit.

BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, kam një problem!
Doktori: Çfarë problemi?
Pacienti: Harroj shpejt.
Doktori: Që sa kohë e keni këtë problem.
Pacienti: Cilin problem?



Në Kino ABC nuk ka shfaqje




FOTO E DITES



Pamje magjepsëse e detit Jon

E rrallë

Studiuesit: Njeriu duhet t'i kalojë me humor edhe situatat dramatike

Të dish të lozësh dhe të jesh i gëzueshëm, është një anë e karakterit që mund të edukohet dhe përmirëson shumë cilësinë e jetës. Pra, kush ka një natyrë energjike dhe lozonjare nuk mërzitet dhe ka aftësinë të shndërrojë çdo situatë të pakëndshme të përditshmërisë në përvojë argëtuese ose përfshirëse. Sipas studimeve të kryera deri më sot, të rriturit që kanë këtë aftësi janë kryesisht njerëz shumë kuriozë, pëlqejnë lojërat e fjalëve e të argumenteve, lojërat psikologjike dhe janë në gjendje të përshtatën e ta shohin anën pozitive të çdo situatë. Studimi i fundit i kryer mbi 533 vullnetarë, të vëzhguar për 12 javë e të ndarë në grupe, ka nxjerrë në pah se njeriu kur ushtrohet për të ç'dramatizuar çdo ndodhi dhe të kthejë në interesante e me nota pozitive çdo përvojë, arrin ta përfitojë dhe ta bëjë të vetën. Deri më sot kjo gjë nuk ishte vërtetuar asnjëherë dhe studiuesit e një grupi universitetesh që kanë punuar për këtë punë kërkimore, kanë vërtetuar se kjo gjë mund të arrihet. Studimi është publikuar në revistën shkencore "Applied Psychology: Health and Well-Being" dhe mban firmën e një bashkëpunimi të "Martin Luther King University Halle Wittenberg", Universitetit të Cyrihut dhe atij të Pensilvanisë.

 <p>DASHI Paratë dhe njohjet e shumta që keni janë një burim i fuqishëm për të përjetuar përvoja të ndryshme.</p>	 <p>DEMI Çfarëdo lloj gjëje që bëni sot ka efekt edhe në jetët e personave të afërt. Do të doni që partneri/ja t'ju qëndrojnë pranë.</p>	 <p>BINJAKËT Secili ka nevojë për pak pushim që ta rikuperojë veten. Është shumë e rëndësishme që sot të uleni që të rigjeneroni energjitë dhe të ndiheni mirë.</p>	 <p>GAFORRJA Miq të dinë si t'ju nxisin. Pozicionimi i yjeve parashikon një situatë të vështirë ku duhet të merrni një vendim për ta çuar diçka përpara ose të qëndroni në vend.</p>	 <p>LUANI Pozicionimi i planetëve sjell në qendër të vëmendjes edhe një herë dashurinë. Nëse po përjetoni një shpërthim pasioni, atëherë gjërat kanë për t'u bërë shumë të nxehta sot.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Kujdesuni për trupin sot. Duhet që ta merrni më shumë në konsideratë veten. Keni mundësinë që të njihni dikë akoma më shumë.</p>
 <p>PESHORJA Sot është dita për të shijuar çaste romantike. Mes teje dhe shpirtit binjak ka shumë pasion dhe aventurë.</p>	 <p>AKREPI Sot jeni gati për ta përjetuar përvojën më të rëndësishme të një jete. Keni mundësinë që të eksploroni zona të panjohura.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot do të surprizoheni nga kolegët e punës. Vendi i vetëm ku nuk prisnit të nisnit një romancë.</p>	 <p>BRICJAPI Pozicionimi i yjeve bën që sot të keni një ditë plot pasion dhe romancë. Së bashku me shpirtin binjak keni për të zbuluar gjëra të tjera për lidhjen si çift.</p>	 <p>UJORI Pasioni mund të zbulohet shumë kolaj sot, në shtëpi. Duhet që të jeni në një gjendje të mirë. Mos u dorëzoni nëse ju dalin disa surpriza të pakëndshme rrugës.</p>	 <p>PESHQIT Kujdes sot me natyrën agresive që keni. Edhe pse njiheni si njerëz që mbaroni punë, sot është momenti për të mos ndikuar te të tjerët.</p>

Tayna shfaqet e zjarrtë nga Kalifornia



Reperja e njohur shqiptare Tayna ndodhet në Kaliforni. Atje po argëtohet derisa po e shijon suksesin e projekteve të fundit muzikore. Tayna nga atje me ndjekësit po ndan imazhe të ndryshme, edhe aso ku shfaqet tejet provokuese në bikini. Me veshjen që ka


zgjedhur në paraqitjen e fundit ka provokuar keq pasi gati sa nuk ka zbuluar gjithçka. Tayna është një nga artistet e cila që nga fillimi i karrierës ka qenë tejet e suksesshme dhe ka vazhduar më pas me të njëjtin sukses edhe sot. Ajo po punon për projekte të reja muzikore.

Rita Ora vë në fokus gjoksin në imazhin e publikuar nga varka



Rita Ora së bashku me motrën e vet ka vajtur për disa ditë pushimi. Ritën nuk është duke e zënë vendi-vend, ku ka filluar disa ditë pushimi në Itali. Këngëtarja ka publikuar disa imazhe në profilin e vet në "Instagram", ku shihet

duke lundruar me varkë teksa në plan të parë vë gjoksin. Përndryshe, lidhja e saj me të dashurin e ri Romain Gavras po shkon si është më së miri. Madje së fundmi kishte zëra për një fejesë, por ende asgjë e konfirmuar.



Arbenita josh fansat me foton ku në fokus vë këmbët


Arbenita Ismajli është bërë një nga emrat më të përmendur në mediat rozë për shkak të aktivitetit të saj në rrjete sociale dhe lidhjes me Feron. E dashura e reperit së fundmi ka shkuar në Greqi për pushime, ku

është duke ndarë imazhe mjaft atraktive me fansat e shumtë në "Instagram". Bukuroshja në imazhet e publikuara shfaqet me një palë bikini rozë, ku në fokus vë belin e hollë dhe këmbët e tonifikuara.

Bluza një numër më i vogël se gjoksi i Anastasiyas

Anastasiya Kvitko po vazhdon t'i provokojë ndjekësit me anë të postimeve që është duke i bërë në rrjetet sociale. Modeluesja ruse së fundmi ka ndarë një imazh ku shfaqet me një fustan dhe bluzë të ngushtë e cila mezi i mbërthen asaj gjoksin super të madh. Kvitko ka arritur famën më të madhe pikërisht me anë të këtyre imazheve, ndonëse shpeshherë kritikohet për fotoshop.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Bekaj, pas transferimit te Tirana: Nuk i ndërrova ngjyrat për të cilat ndihem krenar

Portieri i Kosovës, Visa Bekaj, ka nënshkruar kontratë trevjeçare me skuadrën e Tiranës. “Ju siguroj se do të vazhdoj t’i përfaqësoj denjësisht vlerat e larta kulturore e sportive të qytetit tim, si dhe te klubit ku u rrita. Do të vazhdoj të mbaj të veshur fanellën bardh e blu, pa i ndërruar ngjyrat për të cilat ndihem krenar”, ka thënë Bekaj



PRISHTINË, 30 GUSHT - Portieri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Visar Bekaj, e ka kompletuar transferimin në skuadrën e Tiranës. Bekaj, që është formuar në skuadrën e Prishtinës, vendosi që në këtë afat kalimtar të largohet nga futbollit i Kosovës dhe të transferohet në Shqipëri, duke nënshkruar kontratë trevjeçare me klubin nga kryeqyteti. “Visar Bekaj është afrimi më i ri i Tiranës në këtë merkato. Klubi ka arritur blerjen e kartonit të portierit të suksesshëm të Prishtinës. Me një karrierë të pasur brenda IPKO Superligës së Kosovës, si dhe portier i Përfaqësueses së

Kosovës, 23-vjeçari tashmë është një element kyç në përbërjen e skuadrës dhe vjen si gardiani i portës bardheblu për tre vjetet e ardhshëm. I bindur se do ta japë maksimumin për fanellën e re që do të mbajë veshur, Bekaj bëhet pjesë e ekipit më të madh dhe më të titulluar në vend”, thuhet në njoftimin e Tiranës.

Portieri që ka qenë kapiten i Prishtinës në të kaluarën, derisa në edicionin e fundit ishte zëvendëskapiten, ka thënë se do të përpiqet që gjithmonë t’i përfaqësojë denjësisht vlerat e larta kulturore e sportive të qytetit, ndërsa ndihet krenar që nuk i ka ndërruar ngjyrat e klubit.

“Falënderoj klubin e zezërës FC Prishtina për gjithë kontributin në zhvillim dhe për promovimin tim profesional, në veçanti menaxhmentin e klubit, stafin teknik dhe bashkëlojtarët. Falënderim të jashtëzakonshëm për tifo-grupin ‘Plisat’, me të cilin jam i lidhur ngushtë dhe i respektoj maksimalisht. Ju siguroj se do të vazhdoj t’i përfaqësoj denjësisht vlerat e larta kulturore e sportive të qytetit tim, si dhe te klubit ku u rrita. Do të vazhdoj ende ta mbaj veshur fanellën bardh e blu, pa i ndërruar ngjyrat për të cilat ndihem krenar”, ka thënë Bekaj për faqen zyrtare të Prishtinës.

SHKURT

Liga Shqipëri - Kosovë, shpërthejnë mediat serbe

Mediat në Serbi sikur janë në panik, pasi tashmë edhe zyrtarisht ka nisur iniciativa për bashkimin e Ligës së basketbollit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. B92 shkruan se tashmë iniciativat zyrtare kanë nisur dhe më 10 shtator do të nënshkruhet marrëveshja. “Më 10 shtator do të nënshkruhet një marrëveshje midis Shoqatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Federatës Shqiptare të Basketbollit (FShB) mbi krijimin e një lige të përbashkët të basketbollit, e cila do të organizohet për herë të parë më 2020/21. Kjo ligë e përbashkët do të ketë tetë klube”, shkruan B92 duke dhënë më pas disa hollësi.

Bremeni nuk e lejon Rashicën t’i bashkohet Kosovës

Përfaqësuesja e Kosovës ka marrë një lajm të keq para dy ndeshjeve të para në edicionin e dytë të Ligës së Kombeve. Skuadra e Werder Bremenit nuk lejohet që Milot Rashica të vihet nën urdhrat e Bernard Challandes për shkak të frikës së infektimit me koronavirus. “Duke parë situatën, kemi vendosur bashkë me lojtarët që të mos u bashkohem ekipeve të tyre kombëtare. Udhëtimi me kombëtalet mund t’i mbajë jashtë ndeshjes së turit të parë të Kupës së Gjermanisë dhe ne donim ta shmangnim diçka të tillë”, ka thënë drejtori sportiv i Werder Bremenit, Frank Baumann.

Flamurtari konfirmon 10 futbollistë

Skuadra e Flamurtarit ka filluar punën për edicionin e ri, ku do të garojë në Grupin B të Ligës së Parë. Kuqezinjtë kanë nënshkruar me 10 futbollistë. Ardhmja më e madhe konsiderohet Leart Emini, i cili iu bashkua prishtinasve pas një sezoni të mirë në aspektin individual me Trepçën '89. Me klubin kanë nënshkruar edhe Lorik Maxhuni, Bashkim, Shala, Arbnor Zeqiri, Arnis Latifi, Afrim Ademi, Dorant Ahmetaj, Denis Haliti, Dardan Sekiraqa dhe Etrit Halimi. Flamurtari ka konfirmuar që trajneri i ekipit për edicionin 2020/21 do të jetë Jusuf Tortoshi.

Zabergja rikthehet te Trepça

Sulmuesi Enis Zabergja karrierën futbollistike do ta vazhdojë në skuadrën e Trepçës në Ligën e Parë. Ish-sulmuesi i shumë klubeve në Kosovë e ka konfirmuar vetë lajmin për rikthimin në klubin nga Mitrovica. “Marrëdhëniet e mira me presidentin legjendar Nexhmedin Haxhiu dhe trajnerin Fidam Haxhiu ndikuan që të rikthehem t’i ndihmoj Klubit KF Trepça ku kam luajtur edhe shumë vite të tjera”, ka thënë Zaberxha.

Arrihet marrëveshja, Dzeko kalon te Juventus

Sulmuesi Edin Dzeko është shumë pranë transferimit te Juventus. “Zonja e Vjetër” ka marrë konfirmimin nga sulmuesi boshnjak, por edhe nga skuadra e Romës. Sa iu takon detajeve për kalimin e Dzeko te Juventus, “Corriere dello Sport” shkruan se klubi nga Torino do të paguajë 10 milionë euro për transferimin e sulmuesit. Në varësi të paraqitjeve të tij Roma mund të marrë edhe dy milionë të tjera në formë bonusesh, kurse paga e Dzekos do të jetë 7.5 milionë euro, aq sa ai përfiton edhe te verdhekuqtë aktualisht.

LA Lakers e Milwaukee kualifikohen në raundin e dytë

LOS ANGELES, 30 GUSHT - LA Lakers dhe Milwaukee Bucks kanë kaluar në raundin e dytë të plejofit në NBA. Lakersat të shtunën mbrëma mposhtën Portland Trail Blazersin me

rezultatit 131:122 duke e mbyllur serinë e plejofit të Konferencës Perëndimore me rezultatit 4:1. LeBron James realizoi dyshifror të trefishtë me 36 pikë, 10 kërcime e

dhjetë asistime. Milwaukee ndërkohë triumfoi 118:104 ndaj Orlando Magicut dhe e mbylli serinë e raundit të parë të plejofit në Konferencën Lindore me rezultatit 4:1.

Ndeshjet e plejofit në NBA janë rikthyer të shtunën pas pezullimit disaditor shkaku i protestave pasi ishte qëlluar nga policia në shpinë afro-amerikani Jacob Blake.



La Liga: Messi nuk mund të largohet nga Barcelona

BARCELONË, 30 GUSHT - Padyshim që lajmi më i bujshëm në këtë merkato janë zërat që e lidhin yllin e futbollit Lionel Messi larg klubit që e bëri të njohur. E gjitha, mesa duket, nisi në humbjen dramatike që Barcelona pësoi në "Champions", me rezultatit 8-2 në favor të Bayern Munichut. Shumë janë ekipet që janë interesuar për sulmuesin argjentinas, duke nisur që nga Manchester City e deri tek Interi, dy nga ekipet më favorite për të nënshkruar me lojtarin. Në Manchester, Messi do ta gjente Pep Guardiolen, me të cilin ruan një marrëdhënie të jashtëzakonshme dhe fitoi gjithçka që mund të fitosh në një klub. Ndërsa në Milanon zikaltër do të gjejë tifozë të ekzaltuar për një lojtar që e kanë pas dashur që në fillimet e karrierës. Në kontratën aktuale që ka nënshkruar me Barcelonën thuhet se klauzola për largimin e lojtarit është 700 milionë euro. Megjithatë, vetë Messi pretendon se në kontratë është shkruar që nëse lojtari kërkon largimin nga klubi në përfundim të sezonit, atëherë ai është i lirë të largohet pa as edhe një cent nga Katalonja.



Por në kontratë është shkruar se kjo kërkesë duhet të bëhet gjatë periudhës mars-maj. Duke qenë se karantina shtyu edhe përfundimin e kampionatit, Messi shpreson që edhe kërkesa e shkruar në kontratë të shtyhet bashkë me të. Ndërkaq, liga elitare e futbollit spanjoll, La Liga, ka vendosur që të mbajë anë në këtë "përplasje" Messi-Barcelona dhe t'i dalë në krahë ekipit blaugrana. La Liga ka mbështetur klubin dhe ka argumentuar se mënyra e vetme

për ta parë Messin larg Barcelonës është nëse paguhet klauzola e tij me vlerë 700 milionë euro. "Në lidhje me situatën e kontratës së Lionel Messit dhe Barcelonën, La Liga e sheh të arsyeshme të sqarojë se kontrata është në fuqi dhe ka një klauzolë largimi, e aplikueshme në rast se Lionel Andres Messi vendos të largohet para kohe me vendim të njëanshëm. La Liga nuk do të japë leje për çregjistrimin e lojtarit nga federata, nëse shuma e caktuar në kontratë nuk paguhet".

Mançini: Dua finalen e Ligës së Kombeve

ROMË, 30 GUSHT - Trajneri Roberto Mançini insiston se dëshiron që Italia të luajë futboll të bukur dhe ta arrijë finalen e Ligës së Kombeve. "Axurrët" rikthehen në fushë më 4 dhe 7 shtator me ndeshjet kundër Bosnjës dhe Holandës. "Ne kemi bërë shumë mirë deri tani dhe shpresoj të bëjmë më mirë në vazhdim. Shpresoj ta shikoj Italinë të luajë futboll të bukur dhe ta arrijë finalen e Ligës së Kombeve. Kam thirrur më shumë lojtarë se zakonisht pasi nuk e di gjendjen e disa prej tyre. Neve na mungon një lojtar i rëndësishëm si Verrati, ndërsa Jorginho presim të na bashkohet, megjithëse ende nuk e dimë gjendjen e tij", ka thënë Mançini.



pas trajneri i Italisë foli edhe për fazën e sulmit. "Në sulm ne kemi shumë opsione. Immobilen,

Belottin, Kaputon, Moise Ken apo Lazanjën", ka shtuar Mançini.

SHKURT

Ibra: U ktheva në shtëpinë time

Zlatan Ibrahimoviçiqi e ka quajtur Milanin shtëpi të veten, pak pasi mbërriti në Milano për të nënshkruar kontratë me kuqezinjët. Sulmuesi 38-vjeçar është pajtuar të nënshkruajë kontratë njëvjeçare, nga e cila do t'i fitojë 7 milionë euro. Ai u kthye në Milan në janar si lojtar i lirë nga LA Galaxy. "Kam dashur të kthehem në shtëpi. Tani mund ta fillojmë të punojmë për të korrur rezultate edhe më të mira. Gjithmonë kam thënë, nuk jam këtu për të qenë nuskë, por për të sjellë rezultate, për ta kthyer Milanin aty ku e ka vendin", ka thënë Ibrahimoviçiqi për faqen zyrtare të klubit. Suedezi do ta bëjë testin për Covid-19 dhe do të vetizohet në shtëpi para se t'u bashkohet shokëve të skuadrës për stërvitje. Ai i shënoi 10 gola në 18 ndeshje në Serië A për kuqezinjët sezonin e kaluar.

Xavi: De Bruyne, mesfushori më i mirë në botë

Legjenda e Barcelonës, Xavi Hernandez, ka deklaruar se momentalisht mesfushori më i mirë në botë pa asnjë dyshim është futbollisti i Manchester Cityt, Kevin de Bruyne. "Kevin de Bruyne, nga Manchester City, më duket në një nivel tjetër, brutal, ai është në gjendje ta bëjë diferencën. Ai është mesfushori më i mirë në botë dhe relativisht i ri", ka thënë Xavi. 29-vjeçari ka shënuar 57 gola në 222 ndeshje me Cityn, duke dhuruar edhe 89 asistime.

Atletico e Juve në garë për Suarezin

Pavarësisht se shënoi 21 gola në sezonin e kaluar, Luis Suarezin nuk bën pjesë në planet e trajnerit të ri të Barcelonës. Kjo ka bërë që një numër skuadrash të shikojnë për mundësinë e transferimit të 33-vjeçarit, përfshirë edhe Juventusin. Por, sipas Tancerdi Palmierit, Atletico Madridi po shpreson ta transferojë Suarezin si një zëvendësim për Diego Costan. Për ta transferuar sulmuesin nga Uruguai, Atletico duhet ta mposhtë konkurrencën e Juventusit.

Van De Beek arrin marrëveshje me Unitedin

Mesfushori Donny van de Beek sezonin e ardhshëm do të luajë në Premierë Ligë. Gazetari Fabrizio Romano raporton se holandezi ka pranuar ofertën e Manchester Unitedit dhe do të firmosë deri më 30 qershor të vitit 2025. Edhe Ajax është bindur nga oferta dhe do të përfitojë 50 milionë euro plus bonuse. Në të shkuarën Real Madridi kishte tentuar ta transferonte mesfushorin e spikatur të Ajaxit. Këtë verë në skenë doli edhe Barcelona dhe, sipas medieve, ishte trajneri Ronald Koeman që e donte në skuadër, por Unitedi u tregua skuadër më e shpejtë për transferimin e holandezit.

Interi nxjerr në shitje Eriksenin

Christian Eriksen ishte afrimi i bujshëm i Interit në afatin kalimtar të janarit, por ai mund të largohet që këtë verë. Antonio Conte duket se nuk e miratoi asnjëherë këtë afrim dhe kjo u pa qartë edhe me hapësirat e pakta që i dha futbollistit në fushë, duke e përdorur rrallë nga minuta e parë, pavarësisht se impakti i tij ishte shpesh pozitiv, me gola, asistime e raste për gol që krijonte. Konfirmimi i Contes në bankinë ka komplikuar pozitat e Eriksenit në skuadër, pasi danezi vështirë se do të pranonte një tjetër sezon duke u nisur nga bankina dhe për këtë arsye drejtuesit e Interit po mendojnë shitjen e tij gjatë muajit shtator.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, përfaqësues nga shoqëria civile.

I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku 5 (pesë) vjet;
5. Të ketë përkrahjen e së paku 5 (pesë) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **14.09.2020, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217);

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova rishpall:

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog saveta Kosova, predstavnik civilnog društva

Na osnovu člana 9. i 10. Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjavanja zakonske obaveze za izbor člana Tužilačkog saveta Kosova, Skupština raspisuje konkurs za popunjavanje položaja:

1 (jedan) član/ica, predstavnik civilnog društva.

II. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Republike Kosova, dužan je da ispuni sledeće uslove:

1. Da je državljanin i stanovnik Republike Kosova;
2. Da poseduje visoku stručnu spremu iz oblasti prava;
3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
4. Da ima radno iskustvo o pravnim pitanjima, najmanje 5 (pet) godina;
5. Da ima podršku najmanje 5 (pet) organizacija civilnog društva iz oblasti pravosuđa;
6. Da nije kažnjavan za krivično delo.

II. Civilno društvo dužno je da priloži listi nominiranih kandidata za člana i dokumenta, koja dokazuju da kandidat ispunjava uslove navedene u ovom javnom konkursu.

III. Skupština Kosova podstiče civilno društvo da tokom dostavljanja predloga za člana TSK-a, uzme u obzir multietnički sastav Republike Kosova i priznata načela rodne ravnopravnosti.

Aplikaciji priložiti sledeća prateća dokumenta:

- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi (diplome Univerziteta van zemlje, moraju biti nostrifikovane od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 14.09.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:

Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



REPUBLIC OF KOSOVA

Ministry of Economy and Environment (MEE)
Kosovo Digital Economy Project (KODE)

Request for Bids Goods (One-Envelope Bidding Process)

Country Kosovo

Name of Project Kosovo Digital Economy Project (KODE)

Contract Title Hardware and utilities for National Research Network (NREN)

Credit No: 6285 XK

RFB Reference No. KODE-G-2.2.4.4.a-2020

Date: August 31, 2020

- The Ministry of Economy and Environment (MEE) has received financing from the World Bank toward the cost of the Kosovo Digital Economy Project (KODE), and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for Hardware and utilities for National Research Network (NREN). For this contract, the Borrower shall process the payments using disbursement method, as defined in the World Bank's Disbursement Guidelines for Investment Project Financing, except for those payments, which the contract provides to be made through letter of credit.
- The Ministry of Economy and Environment (MEE) - Kosovo Digital Economy Project (KODE) now invites sealed Bids from eligible Bidders for *Hardware and utilities for National Research Network (NREN), which includes establishment an NREN Data Center with Hybrid Cloud Solution and related operational infrastructure which connect Higher Education Institutions' campuses in Kosovo to enable them to use applications and services.*
- Bidding will be conducted through international competitive procurement using a Request for Bids (RFB) as specified in the World Bank's "Procurement Regulations for IPF Borrowers" dated July 2016, revised November 2017 ("Procurement Regulations"), and is open to all eligible Bidders as defined in the Procurement Regulations.
- Interested eligible Bidders may obtain further information from Ministry of Economy and Environment (MEE) - Kosovo Digital Economy Project (KODE), Mr. Luan Asllani, E-mail: mzhe.tik@rks-gov.net and inspect the bidding document during office hours 0900 to 1600 hours (Kosovo time) at the address given below.
- The bidding document in **English language** may be obtained by interested Bidders upon the submission of a written request (e-mail) to the address below. The document will be sent by e-mail.
- Bids must be delivered to the address below on or before **October 14, 2020**. Electronic Bidding **will not** be permitted. Late Bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the Bidders' designated representatives and anyone who chooses to attend at the address below on **October 14, 2020 at 14.00h Kosovo time**.
- All Bids must be accompanied by a **Bid Security in a sum of 15,000.00 Euro**.
- The address(es) referred to above is:

Ministry of Economy and Environment (MEE) - Kosovo Digital Economy Project (KODE),

Attn: Luan Asllani, Procurement Specialist MEE-KODE-PIU

Mother Theresa Str. No.36, 10000, Prishtina, Kosovo

Phone: +383 38 200 21587

E-mail mzhe.tik@rks-gov.net

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Gezim Selmani shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Emin Kasami shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Remzi Banovi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Lirik Spahiu shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.